

PARATHËNIE

Të gjitha falenderimet i takojnë Allahut dhe paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin e Tij, Muhamedin.

Ky libër ka për qëllim të hapë një dritare të vogël për në fenë Islame dhe praktikimin e saj, në mënyrë që t'u vijë në ndihmë fillestarëve të cilët dëshirojnë të mësojnë bazat e Islamit.

Libri është i ndërtuar në tre kapituj. Kapitulli "Islami - Feja universale" paraqet një vështrim të përgjithshëm në lidhje me pikëpamjet Islame rreth botës që na rrethon. Ai parashtrohet pyetje të tilla, si: "Kush jam unë?" dhe "Përse jam në këtë botë?" Në të jepen informacione të bazuara në traditën islamike në mënyrë që këtyre pyetjeve t'u jepen përgjigje bindëse. Pastaj jepet një biografi e shkurtër e Profetit Muhamed, me qëllim që ta ndihmojë lexuesin të krijojë një këndvështrim të saktë nga pikëpamja historike në lidhje me rolin e tij në Islam. Më pas janë paraqitur fakte rreth Kur'anit dhe disa prej aspekteve të tij që kanë të bëjnë me autorësinë hyjnore dhe ruajtjen e tij. Në fund, diskutohet rreth qytetërimit Islam duke bërë një retrospektivë në histori, të shoqëruar edhe me komente të dijetarëve perëndimorë.

Kapitulli i dytë thellohet në studimin e besimit Islam dhe gjashtë kushteve të tij të cilat janë: besimi në Zot, në engjëjt, në librat hyjnorë të shpallur, në profetët, ringjalljen dhe në paracaktimin hyjnor. Racionaliteti i fesë Islame shpjegohet nëpërmjet citimeve nga vargjet Kur'anore dhe thëniet profetike. Parabola dhe komentet nga Bediuzzaman Said Nursi e pasurojnë përmbajtjen dhe ndikojnë për ta kuptuar më lehtë atë.

Kapitulli i tretë bën fjalë për praktikën e besimit Islam, të cilat përkufizohen si "pesë shtyllat e Islamit." E ndërsa kapitujt paraardhës fokusohen në krijimin e bindjes në zemër, ky seksion në njëfarë mënyre jep informacione në lidhje me aspektin e jashtëm të fesë, që konsiston në: deklarin e besimit, faljen e namazeve, agjërimin e Ramazanit, dhënien e zekatit, si dhe kryerjen e haxhit. Tekste të shkëputura të disa vargjeve Kur'anore dhe lutjeve të tjera janë dhënë në fund të librit, të shoqëruara me foto që tregojnë se si duhen kryer ritualet e përditshme të faljeve.

Dua të falënderoj miqtë në vijim, të cilët kontribuan për këtë libër me anë të këshillave të tyre të dobishme, me korrigjimet, si dhe me komentet e tyre. Ata janë: Ali Ynal, Bonnie Rutherford Shahin, Kathleen St. Onge, Jane Louise Kandur, Ahmet Kuruxhan dhe Huseyin Senturk.

Islami – Feja universale

Qëllimi i jetës dhe besimit

Vështrim Islam në lidhje me njerëzit

Profeti Muhamed

Kur’ani

Qytetërimi Islam

Qëllimi i jetës dhe besimit

Kush jam unë? Nga vij? Ku do të shkoj? Çfarë kërkon vdekja nga unë? Kush është udhërrëfyesi im në këtë udhëtim?

Për të gjitha këto pyetje që kanë të bëjnë me çështjet themelore të jetës së njeriut, si dhe me lumturinë tonë intelektuale dhe atë shoqërore, lypset të jesh i aftë për t’u dhënë përgjigjet e duhura, ashtu siç nevojitet edhe kanalizimi i aftësive tona, në mënyrë që ne të mundësojmë ndërtimin e një jete të harmonishme dhe paqësore, si në planin individual, ashtu edhe në atë shoqëror. Meqenëse nuk është e mundur për intelektin njerëzor të kuptojë plotësisht se ku qëndron lumturia e vërtetë e njeriut, atëherë njerëzimit i nevojitet si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën, një intelekt universal, një udhëheqje që buron nga përtej arsyes dhe përvojës njerëzore, autoritetit të së cilës të gjithë të mund t’i nënshtrohen me vullnet të lirë. Kjo udhëheqje është feja e shpallur dhe e përsosur nga Zoti nëpërmjet Profetëve të Tij¹. Me Islamin, Zoti e plotësoi fenë që Ai zgjodhi dhe shpalli për njerëzimin:

Sot përsosa për ju fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha për ju Islamin fe. (Maide 5:3)

Islam do të thotë “nënshttrim ndaj Zotit, paqe dhe shpëtim.” Vetëm nëpërmjet nënshttrimit ndaj Zotit, një njeri mund të fitojë paqen si në planin individual, ashtu edhe në atë shoqëror, si dhe të gjejë shpëtimin në të dyja botët. Kjo është arsyeja përse të gjithë profetët erdhën me të njëjtën doktrinë besimi, me të njëjtat norma adhurimi dhe virtyte, si dhe me të njëjtat parime në lidhje me rregullat e jetës shoqërore. Vetëm në disa çështje të dorës së dytë, ata ndryshonin nga njëri-tjetri, dhe kjo vinte vetëm e vetëm si pasojë e kushteve dhe epokave të ndryshme në të cilat ata u dërguan dhe jetuan.

Emri i fesë që përfshin këtë doktrinë dhe këto koncepte e parime, është Islam. Feve të tjera, emrat u janë vënë ose nga pasuesit e tyre, ose nga kundërshtarët dhe ato u janë vënë pasi kishte kaluar njëfarë kohe që kur të dërguarit përkatës e kishin lënë këtë botë. Islami është feja e përjetshme dhe ai nuk solli asgjë që mund të konsiderohej krejtësisht e re, por ai erdhi për të risjellë në origjinë fenë burimore, si dhe për të ripohuar të Vërtetën, e cila e kapërcente konceptin “kohë”. Duke qenë një rivënie në vend dhe ripohim, Islami përbën një sintezë të Shpalljes së përbotshme; ai është përmbledhja e të gjitha mesazheve paraardhëse të cilat Zoti ua besoi njerëzve. Është pikërisht Islami ai i që u jep aftësinë e mahnitshme për t’u integruar brenda një komuniteti të vetëm besimtarëve me prejardhje krejt të ndryshme etnike, duke respektuar njëkohësisht edhe veçoritë e tyre².

Të gjithë profetët u dërguan me mesazhin Islam dhe e komunikuan atë, por pasuesit e tyre dështuan në respektimin dhe në ruajtjen e tij, duke bërë ndryshime herë pas here. Ky mesazh u komunikua për të fundit herë nga Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, në një mënyrë të tillë që të mund t’i përfshinte të gjithë njerëzit deri në fund të ekzistencës së kësaj bote. Prandaj, vetëm Islami që predikoi Profeti Muhamed është i pranuar nga Zoti si feja e vërtetë:

Thuaj: “Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait dhe Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre dhe ne vetëm Atij i përulemi.” (Al Imran 3:84)

Është e rëndësishme të theksohet se Profeti Muhamed nuk është themeluesi i Islamit, por i Dërguari i Islamit. Islami është mënyra e natyrshme e jetesës. Zoti është burimi i Islamit dhe Ademi, njeriu i parë në tokë, ishte muslimani i parë. Po kështu, Profeti Ibrahim, i cili jetoi 2500 vjet përpara Profetit Muhamed, në Kur’an është quajtur musliman (Al Imran 3:60). Të gjithë profetët përcollën të njëjtin mesazh nga Zoti – mesazhin e Islamit, të paqes dhe mëshirës³.

Në aspektin e tij më themelor, Islami personifikohet në frazën më të përdorur të të gjithë Kur’anit, Bismelen ose Bismil’lahi Rrahmani Rrahim – “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.” Zoti e shfaq Vetveten nëpërmjet Mëshirës dhe Dhembshurisë së Tij Absolute dhe Islami është themeluar mbi bazën e këtij pohimi. Kur’ani e quan misionin e Profetit Muhamed “një mëshirë për të gjitha botërat” (Haxh 21 :107)⁴.

Qëllimi hyjnor i krijimit të njerëzisë dhe botës

Meqenëse Zoti i Vetëm i Vërtetë është i Pafundëm dhe Absolut sikurse është edhe pafundësisht i Mirë, Ai realizoi krijimin. Pafundësia e Tij nënkupton që Ai i zotëron në Vetvete të gjitha potencialet që duhej të konkretizoheshin në formën e krijimit. Është në natyrën e së mirës dhënia e diçkaje nga vetvetja, ndaj Pafundësisht i Miri nuk mund të mos e rrezatonte këtë cilësi në realitetin që përbën botën⁵.

Ne nuk e kemi krijuar kot qiellin, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre. Kjo është hamendja e jobesimtarëve. (Sad 38 :27)

Thënia e shenjtë e mëposhtme e Profetit Muhamed, (hadith kudsî⁶), e shpjegon më së miri arsyen e thellë të krijimit, e cila është “dëshira e Zotit për t’ua bërë Vetën të njohur krijesave të Tij, e realizuar nëpërmjet mëkëmbësit të Tij në tokë – njeriut.”

“Unë isha një thesar i fshehtë dhe dëshiroja të më njihnin, ndaj që të bëhesha i njohur tek të tjerët, realizova krijimin.”

Për një qenie njerëzore, të njohë Zotin do të thotë të përmbushë qëllimin e krijimit. Për ta kuptuar më mirë qëllimin hyjnor të krijimit të njerëzimit dhe të gjithësisë, na vjen në ndihmë parabola e mëposhtme nga Bediuzzaman Said Nursi⁷. Bediuzzamani (1877 – 1960) është një prej dijetarëve të mëdhenj të Islamit, përmbledhja e të cilit, Risale-i Nur (Mesazhet e Dritës), studiohet në shkallë të gjerë nga muslimanët, sidomos në Turqi. Risale-i Nur konsiderohet si një interpretim modern i Kur’anit, që bën të mundur parashtrimin e argumentave më bindës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me besimin:

Një parabolë në lidhje me qëllimin e krijimit

Një mbret kishte një thesar të madh me gurë të çmuar që i mbante për vete. Ai kishte njohuri të mira rreth industrisë dhe i njihte po kaq mirë të gjitha disiplinat artistike dhe ato shkencore. Çdokush që zotëron bukuri dhe përsosmëri, natyrisht që dëshiron t’ua përçojë të tjerëve⁸, ndaj edhe ai donte të ndërtonte një pallat me anë të të cilit të shfaqte shkëlqimin e mbretërisë së tij, madhësinë dhe madhështinë e pasurisë së tij, si dhe produktet e mrekullueshme të talentit dhe zotësisë së tij. Ai gjithashtu dëshironte të kundronte bukurinë dhe përsosmërinë e tij me sytë e vet, por edhe nëpërmjet syve të të tjerëve.

Kështu, ai nisi të ndërtonte një pallat shumë të madh e të mrekullueshëm. Pasi e ndau atë në dhoma dhe apartamente, i zbukuroi ato me vepra arti nga më të bukurat dhe më të rafinuarat, si dhe e stolisi me gurët e tij të çmuar. Pasi e ndërtoi pallatin sipas të gjithë parametrave më të përparuar artistikë dhe shkencorë, e pajisi me produktet e mrekullueshme që buronin nga dija e tij. Në fund, ai përgatiti ushqime të shijshme dhe pije për secilën familje që do të jetonte aty, duke i gatuar ato aq mjeshtërisht, saqë çdo ushqim dukej se përmbante të paktën 100 shije të ndryshme.

Pastaj mbreti vendosi disa nga shtetasit e tij në këtë pallat. Dërgoi ordinancën e tij për t'u shpjeguar atyre përse u ndërtua ky pallat, rregullave të të cilit banorët e tij duhej t'u bindeshin, ç'lloj qenieje ishte mbreti, si dhe t'u fliste atyre rreth arkitekturës, zbukurimeve, mobiljeve dhe stolive të pallatit. Ai i tha ordinancës t'u shpjegonte banorëve se si e shfaq struktura, ndërtimi dhe përmbajtja e pallatit nivelin e lartë artistik dhe përsosmërinë e mbretit dhe se në ç'mënyrë ata që banonin në pallat, mund t'ia shprehnin falenderimet atij.

Ordinanca kishte shumë vartës dhe secili nga ndihmësit e tij të panumërt u urdhërua të shkonte në një apartament të caktuar. I rrethuar nga ndihmësit e tij, ai iu drejtua me këto fjalë banorëve të pallatit:

O njerëz! Mbreti ynë i cili është pronari i këtij pallati, e ndërtoi atë që të bëhet i njohur për ju. Në këmbim, ju duhet ta njihni dhe ta vlerësoni siç duhet. Ai dëshiron të bëhet i dashur për ju nëpërmjet këtyre stolive. Prandaj vlerësoni nivelin e tij të lartë artistik dhe lavdërojeni për veprat e tij, që ai pastaj t'ju dojë. Të mirat që ai ju ka dhuruar, tregojnë dashurinë e tij për ju, prandaj shfaqni edhe ju dashurinë tuaj për të duke iu bindur. Këto dhurata të tij, janë shenjë e kujdesit dhe dhembshurisë që ka për ju, prandaj falenderojeni duke treguar respektin tuaj për të. Përmes veprave që burojnë nga përsosmëria e tij, mbreti dëshiron të paraqesë bukurinë dhe hijeshinë e tij. Prandaj edhe ju duhet të shfaqni një dëshirë të madhe për ta parë dhe për të tërhequr vëmendjen e tij. Duke vënë vulën e tij të veçantë, e cila nuk mund të kopjohet, në gjithçka që ju shihni, ai ka dashur të tregojë se është unik, krejtësisht i pavarur dhe pa asnjë rival, ndaj ky pallat dhe gjithçka ka në të, janë vepër e tij dhe i përkasin vetëm atij. Kështu që njiheni njësinë e tij, pavarësinë e tij absolute si dhe mungesën e rivalëve të tij.

Ordinanca e vazhdoi thirrjen e tij. Banorët e pallatit ishin dy llojesh. Njerëzit e grupit të parë të cilët ishin të ndjeshëm dhe të ndërgjegjshëm, i panë mrekullitë e pallatit dhe arritën në përfundimin se gjithçka e ka një qëllim. Duke menduar rreth kësaj çështjeje, ata e dëgjonin me vëmendje ordinancën dhe në fund e morën vesh se cili ishte ky qëllim. Ata bënë gjithçka

dëshironte mbreti, duke fituar kënaqësinë e tij. Në këmbim, mbreti i ftoi në një pallat edhe më të madh dhe me bukuri të papërshkrueshme dhe të pakrahasueshme me pallatin e parë, ku u dha pastaj të gjitha llojet e mirësive dhe bekimeve të përjetshme.

Njerëzit e grupit të dytë ishin të shthurur moralisht, të papërgjegjshëm dhe të paarsyeshëm, prandaj gjithçka që sytë e tyre shihnin, ishte vetëm ushqimi i shijshëm. Ata gjithashtu nuk arrinin ta kuptonin domethënien e zbukurimeve dhe stolive. Ata u përqendruan vetëm tek e ngrëna dhe gjumi, duke i injoruar kështu fjalët dhe porositë e ordinancës së mbretit. Pasi pinë pije të ndaluara, ata u dehën, bezdisën shërbëtorët dhe të ftuarit e pallatit duke thyer kështu të gjitha rregullat. Prandaj mbreti i ftoi ata në burg.

Shkurt, mbreti i lavdishëm e ndërtoi pallatin për qëllimet e bëra të njohura nga ordianca e tij. Të kuptuarit e këtyre qëllimeve varet nga dy aspekte. Së pari, nëse ordianca nuk do të ekzistonte, ato qëllime nuk do të shpjegoheshin dot sepse një libër pa një mësues që ta shpjegojë atë, është vetëm një grumbull me letra. Së dyti, ordianca duhet të jetë i bindur se ekzistenca e tij, është një arsye për ndërtimin e pallatit dhe se bindja e banorëve është kusht për mirëmbajtjen e tij. Pa një ordiancë që t'ua tregojë sekretet e pallatit banorëve dhe t'u flasë atyre në lidhje me dëshirat e mbretit, ky i fundit nuk do ta kishte ndërtuar atë. Gjithashtu, në qoftë se ata do të injoronin udhëzimet e mbretit, atëherë pallati do të shkatërrohej.

Në qoftë se e kuptoni këtë shembull, mendoni pak në lidhje me domethënien e tij. Pallati është kjo botë, çatia e të cilës është qielli i ndriçuar me yje shndritës, kurse dysHEMEJA është sipërfaqja e tokës e zbukuruar me lloje të shumta lulesh. Mbreti është Zoti, më i Shenjti, Mbreti i Përjetshëm, të Cilit shtatë shtresat e qiejve dhe toka me gjithçka ka në mes tyre, i thurin lavde dhe e madhërojnë me gjuhën e veçantë të secilës specie. Ai është një Mbret kaq i Plotfuqishëm, sa që i krijoi qiejt dhe tokën në 6 ditë⁹. I ulur në Fronin e Tij të Mbretërimit (domethënë nëpërmjet shfaqjeve të vazhdueshme të Mbretërimit të Tij¹⁰), Ai i ndërron ditët dhe netët sikur të ishin fletë të bardha dhe të zeza të një libri, me qëllim që të hedhë firmën e Tij në fletën e gjerë të universit. Ai është i Vetmi, Madhështori dhe i Plotfuqishmi, të cilit i janë nënshtruar dielli, hëna dhe të gjithë yjet.

Dhomat e pallatit janë mijëra botërat, çdonjëra prej tyre e skicuar, e pajisur dhe e zbukuruar në mënyra të ndryshme. Veprat e bukura dhe mjeshtërore artistike janë ato çfarë ne shohim këtu, çdonjëra prej të cilave përbën një mrekulli më vete të Fuqisë Hyjnore; ushqimi nënkupton frutat e mrekullueshme të Mëshirës Hyjnore që ne shohim përreth. Gurët e çmuar simbolizojnë Emrat e Shenjtë Hyjnorë dhe stolitë përfaqësojnë gjallesat e krijuara në mënyrë të përkryer, si dhe

nënshkrimet e përpjesëtuara në mënyrë të përkryer nga ana e Lapsit të Fuqisë që hijeshon këtë botë dhe shkruan Emrat e Madhështorisë dhe të të Plotfuqishmit.

Ordinanca është zotëria ynë, Profeti Muhamed. Ndihmësit e tij janë profetët e tjerë dhe shërbëtorët janë të gjithë evlijatë dhe dijetarët e pastër. Vartësit janë engjëjt, banorët e pallatit nënkuptojnë njerëzimin dhe miqtë e ftuar janë ato kafshë të cilat janë krijuar për t'i shërbyer atij. Grupimi i parë i njerëzve janë besimtarët, studiuesit e Kur'anit, i cili është interpretues i vargjeve të Librit të Gjithësisë. Grupi i dytë përbën jobesimtarët dhe rebelët, 'shurdhmemecët', njerëzit në rrugë të keqe të cilët me bindjen që tregojnë ndaj dëshirave trupore dhe djallit, pranojnë vetëm jetën e kësaj bote duke e ulur veten e tyre më poshtë se kafshët.

Grupi i parë që përbëhej nga njerëz të mirë dhe me botë shpirtërore të pasur, e dëgjoi mesazhin e këtij zotërie që ishte i pajisur me një intelekt të ndritur dhe me dëlirësi shpirtërore, rrugë këto që të çojnë drejt përparimit në të dy botët. Ky zotëri është edhe shërbëtor, edhe i Dërguar; ai është një shërbëtor adhures nga njëra anë në raport me rolin e tij si përshkrues i mbretit të tij Suprem dhe bërjes së Tij të njohur për njerëzit; një përfaqësues i bashkësisë së tij në trupin gjykues të Zotit të Madhëruar dhe nga ana tjetër, ai është një i Dërguar i cili i përmbahet me përpikmëri detyrës si përcjellës i mesazhit, duke ua përçuar udhëzimet e Mbretit të tij njerëzimit nëpërmjet Kur'anit.

Si përgjigje ndaj sjelljeve të Mbretit të Përhershëm në lidhje me Mbretërinë e Tij dhe me shfaqjen e Njëshmërisë së Tij nëpërmjet krijimit të Universit, ata e besuan dhe e pohuan këtë Njëshmëri (Teuhid) dhe treguan bindje e nënshtrim me fjalët: "Dëgjuam dhe u bindëm." Shfaqjes së aspektit Hyjnor të Zotit të botërave ata iu përgjigjën me adhurim, duke thënë se pafuqia e tyre i kishte rrënjët tek dobësia, varfëria e tyre i kishte rrënjët tek nevoja, prandaj doli në pah domosdoshmëria e kryerjes së namazeve (thelbit të adhurimit).

E ndërsa në atë xhami të madhe të botës iu përkushtuan këtyre, si dhe detyrave të tjera të ngjashme me to që kishin të bënin me adhurimin, ata u bënë shembulli më i mirë i krijimit. Mbi të gjitha krijesat e tjera, ata u bënë mëkëmbësit e besuar të Zotit, të pajisur me bekimin e besimit dhe të besnikërisë¹¹. Pas kësaj prove apo testi, për të shpërblyer përkushtimin e tyre ndaj Islamit, Zoti i tyre Bujar e shpërbleu besimin e tyre me lumturi të përjetshme dhe i ftoi ata në ngrehinën e Paqes. Atje, falë mëshirës së Tij, ata përfitojnë të mira që i lënë pa mend dhe që janë përtej përshkrimit dhe përfytyrimit njerëzor, si dhe kanë një jetë të përhershme dhe të përjetshme. Dëshiruesit dhe kërkuesit e bukurive të tilla të përhershme, do të shkojnë drejt përjetësisë. I tillë

është fundi dhe stacioni i mbramë i atyre që e studiojnë Kur'anin. Zoti i Gjithëmëshirshëm na përfshiftë edhe ne në mes tyre. Amin!

Pjesëtarët e grupit të dytë, që të gjithë mëkatarë dhe njerëz të ligj, hyjnë në këtë pallat në moshën e pjekurisë¹². Mosbesues ndaj Njëshmërisë Hyjnore dhe mosmirënjohës ndaj të mirave, ata i fyejnë të gjitha krijesat, duke i quajtur të pavlera dhe duke refuzuar e mohuar shfaqjen e Emrave Hyjnorë. Shkurt, ata bëjnë një gabim të madh në një kohë të shkurtër dhe përfitojnë ndëshkim të përjetshëm.

Ne na është dhënë kjo pasuri e madhe që është jeta dhe aftësitë njerëzore për t'i shpenzuar ato në kryerjen e detyrave të lartpërmendura. Prandaj detyra jonë nuk ngushtohet në të jetuarit e një jete të lehtë dhe në kënaqjen e epsheve tona. As aftësitë tona, as shqisat tona delikate, as organet, as sistemet nervore të mirësistemuara e as ndjenjat dhe kureshtja jonë - të gjitha këto të përfshira në “makinerinë” e jetës sonë (trupit tonë) - nuk na janë dhënë për të kënaqur epshet dhe dëshirat tona trupore. Përkundrazi, ato janë futur brenda dhe janë bërë pjesë e natyrës sonë për dy arsye: së pari, për të na dhënë mundësinë të shijojmë të gjitha llojet e mirësive që burojnë nga Dhuruesi i vërtetë i të Mirave dhe për të na nxitur që të jemi mirënjohës. Në këtë mënyrë, duke i shijuar ne i jemi mirënjohës Atij. Arsyeja e dytë është të na bëjë të njohur dhe të na shtyjë të përjetojmë të gjitha shfaqjet e secilit prej Emrave Hyjnorë të Shenjtë të vëzhguara në gjithësi. Kështu ne i përjetojmë, i njohim dhe i besojmë ato. Në qoftë se jemi në gjendje t'i kuptojmë këto, mund të arrijmë një nivel të lartë përsosmërie njerëzore dhe të bëhemi qenie të vërteta njerëzore në kuptimin e plotë të fjalës.

Pasha diellin dhe shkëlqimin e tij! Pasha hënën që e përcjell atë! Pasha ditën që ia zbulon shkëlqimin atij (diellit)! Pasha natën kur e mbulon atë! Pasha qiellin dhe Atë që e ka ndërtuar! Pasha tokën dhe Atë që e ka shtruar! Pasha njeriun dhe Atë që e ka përsosur! Duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën. Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e poshtëron atë, do të dështojë. (Shems 91:1-10)

Pikëpamjet Islame rreth njerëzimit

Mëkëmbësi i Zotit në Tokë

(Përkujto Muhamed) kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj në tokë një mëkëmbës!” Ata i thanë: “A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e që derdh gjak në të, ndërkohë që ne të

madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!”

E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: “Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”

“Qofsh i lavdëruar! – thanë ata, - ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti!”

“O Adem, - tha ai, - ua trego atyre emrat gjërave!” Kur ai ua tregoi emrat e tyre, (Zoti) tha: “A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiejve e të tokës dhe vetëm Unë e di çfarë tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?”

“E kur u thamë engjëjve: “Përluni në sexhde para Ademit”, ata u përlën.” (Bekare 2:30-34)

Raca njerëzore është superiore ndaj të gjitha krijesave të tjera, në kuptimin që Zoti zgjodhi qeniet njerëzore si mëkëmbësit e Tij në tokë. Ademi qe njeriu i parë, gjithashtu Profet dhe ai ishte superior ndaj engjëjve, sepse ishte bekuar me dije për emrat e çdo sendi dhe ishte gjithashtu pasqyrim i të gjithë Emrave dhe Cilësive Hyjnore. Epërsia e njeriut nuk tregohet vetëm me Ademin, por konfirmohet gjithashtu me një varg tjetër Kur'anor: “Vërtet Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.” (Tin 95:1-4). Prandaj, sipas Islamit, njerëzit nuk kanë lindur në këtë botë me një gabim në kurriz që duhet shlyer, por përkundrazi, njerëzit mishërojnë shumë cilësi të mira si mëshira, bujaria dhe dhembshuria, ndaj, prej njerëzve pritet që t'i përjetojnë këto ideale fisnike të njerëzimit.

Cilësia e të qenurit njerëz buron nga aspekti ynë jomaterial dhe shpirtëror, dhe jo nga aspekti ynë natyral dhe ai material. Shpirti dhe mendja nuk e kanë zanafillën tek trupi fizik, përkundrazi, shpirti e përdor trupin dhe vetëm jeta i jep trupit kuptim.

Ne zotërojmë tri ndjenjat kryesore: dëshirën, zemërimin dhe intelektin. Ne kemi dëshira apo tundime nga seksi i kundërt dhe i duam fëmijët tanë dhe pasuritë e kësaj bote. Ne e drejtojmë zemërimin drejt atyre që na pengojnë në rrugën tonë dhe duke e përdorur atë, arrijmë të mbrojmë vetveten. Intelekti ynë na aftëson të marrim vendimet e duhura. Krijuesi nuk na i kufizon këto ndjenja, por përkundrazi, kërkon prej nesh të qëmtojmë përsosmërinë nëpërmjet vetëdisiplinimit, në mënyrë që të mos i keqpërdorim ato. Në qoftë se ndjenjat mbeten të padisiplinuara, atëherë imoraliteti, marrëdhëniet seksuale të jashtëligjshme, shtëpitë e ndaluara, tirania, padrejtësia, mashtrimi, falsiteti dhe vese të tjera do të shfaqen tek individët dhe nëpërmjet

tyre, do të përhapen në të gjithë shoqërinë. Vargu i mësipërm Kur'anor "Vërtet Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer", pasohet nga vargu tjetër, "Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të kenë shpërblime të pandërprera." Ky varg thekson nevojën për një disiplinë qiellore për të na shpëtuar nga shndërrimi në më të ultin e të ultëve, prandaj njeriu është gjithmonë përballë rrezikut të dështimit në provimin e jetës së kësaj bote.

Të gjithë njerëzit janë të barabartë

O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. S'ka dyshim se më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijsëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë. (Huxhurat 49:13)

Siç shihet qartë, në vargun e mësipërm kur'anor, pikëpamjet Islame në lidhje me racën njerëzore, janë të orientuara drejt barazisë dhe nuk tolerojnë asnjë lloj diskriminimi mbi baza gjinie, race, ngjyre, familjeje, pozite social-ekonomike, kulture apo kombësie. Kriteri i vetëm i superioritetit është "mëshira, drejtësia dhe adhurimi i Zotit" dhe kjo është e mundur të dihet vetëm nga Zoti. Të gjithë njerëzit janë pasardhës të Ademit dhe Havasë dhe në këtë kuptim, ne jemi të gjithë vëllezër e motra.

Racizmi përbën një nga problemet më të mprehta të epokës sonë. Kur i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të) u shpall profet, racizmi ishte shumë i theksuar në Mekë, i maskuar nën rrobën e farefisnisë. Kurejshët e konsideronin veten (në veçanti) dhe arabët (në përgjithësi) si qenie superiore ndaj njerëzve të tjerë. I Dërguari i Allahut erdhi me këtë mesazh hyjnor dhe shpalli: "Arabi nuk është superior ndaj joarabit dhe i bardhi nuk është superior ndaj të ziut¹³, dhe "Në qoftë se një musliman zezak abisinas vihet në udhëheqje të muslimanëve, atij duhet t'i bindeni¹⁴".

I Dërguari i Allahut e çrrënjosi racizmin mbi baza ngjyre të lëkurës dhe diskriminimin me aq sukses, sa që për shembull, Omeri njëherë tha për Bilalin që ishte zezak: "Bilali është zotëria ynë dhe është çliruar nga zotëria ynë Ebu Bekri¹⁵". Njëherë Ebu Dheri u zemërua me Bilalin dhe e fyeu me fjalët "I biri i zezakes!" Bilali shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe ia tregoi incidentin me lot në sy. I Dërguari i Allahut e qortoi Ebu Dherin duke i thënë: "A mos ke akoma shenja të injorancës?" Plot pendesë, Ebu Dheri u shtri në tokë dhe tha: "Unë nuk do ta ngre kokën (d.m.th.

nuk do të ngrihem) derisa Bilali të vendosë këmbën e tij përmbi kokën time.” Bilali e fali dhe ata u pajtuan¹⁶. Zejd ibn Harith, një skllav zezak i liruar nga i Dërguari i Allahut, ishte djali i adoptuar i tij përpara se Shpallja t’i ndalonte këto lloj adoptimesh. Profeti e martoi atë me Zejneb bintu Xhahsh, një nga gratë më fisnike arabe dhe muslimane, e cila, për më tepër, nuk ishte zezake. Madje ai e zgjodhi Zejdin si komandant të ushtrisë muslimane që u dërgua kundër ushtrisë së Mbretërisë Bizantine, edhe pse mes luftëtarëve ndodheshin sahabe të tillë si Ebu Bekri, Omeri, Xhafer ibn Talibi (kushëri i të Dërguarit të Allahut) dhe Halid ibn Velidi (i famshëm për zgjuarsinë e tij dhe si komandant i madh ushtarak)¹⁷. Profeti caktoi të birin e Zejdit, Usamen, për të drejtuar ushtrinë që formoi pak përpara se të vdiste. Në këtë ushtri ndodheshin sahabe të tillë të shquar si Ebu Bekri, Omeri, Halidi, Ebu Ubejde, Talha dhe Zubejri. Ky veprim i bindi mendjet dhe zemrat e muslimanëve për faktin se epërsia nuk vjen nga lindja, gjaku apo nga ngjyra e lëkurës, por nga drejtësia dhe përkushtimi ndaj Zotit.

Në Islam, të gjitha krijesave u është garantuar afrimi i barabartë tek Zoti. Nuk ekziston asnjë kategori e veçantë e privilegjuar klerikale dhe as nuk i është premtuar ndonjë favorizim ndonjë grupi të caktuar njerëzish. Të gjithë besimtarët janë njëlloj shërbëtorë të Zotit, ndaj nuk është nevoja për ndërmjetës.

Islami nuk është i vlefshëm vetëm për një familje apo për një popull; ai nuk është një marrëveshje e bërë me një grup të zgjedhur njerëzish. Islami përfshin gjithë njerëzimin, madje edhe krijesat më të vogla.

Profeti Muhamed

Nëse do ta imagjinonim veten në botën e para 1400 viteve, ne do të gjendeshim në një vend krejtësisht të ndryshëm. Mundësia e shkëmbimit të ideve do të ishte e pakët dhe mjetet e komunikimit të kufizuara e të pazhvilluara. Errësira do të mbizotëronte dhe vetëm një dritë e vogël dijeje e pamjaftueshme për të ndriçuar horizontin e dijeve njerëzore do të mund të shihej. Njerëzit e asaj kohe kishin një vizion të ngushtë dhe idetë e tyre në lidhje me njerëzimin dhe botën, ishin të kufizuara në rrethinat e tyre. Të zhytur në injorancë dhe në bestytëni, mosbesimi i tyre ishte kaq i fuqishëm dhe i përhapur, sa që ata refuzonin të pranonin ndonjë gjë si të lartë dhe sublime, deri kur ajo të shfaqej nën mantelin e të mbinatyrshmes. Ata kishin zhvilluar një kompleks kaq të madh inferioriteti, sa që nuk arrinin të përfytyronin një njeri që të kishte shpirt hyjnor apo dispozita të shenjta.

Atdheu i Profetit (a.s.)

Në atë epokë prapambetjeje, errësira ishte shtrirë më gjerë se kudo tjetër në atë vend. Vendet fqinje si Persia, Bizanti dhe Egjipti, zotëronin pak qytetërim dhe një rreze të zbehtë diturie, por Gadishulli Arab, i izoluar dhe i kufizuar nga oqeanet të mëdhenj rëre, ishte nga pikëpamja kulturore dhe intelektuale një nga rajonet më të prapambetura të globit. Hixhazi, vendlindja e Profetit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, nuk kishte mundur të arrinte as edhe zhvillimin e kufizuar të rajoneve fqinje dhe nuk kishte përjetuar asnjë lloj zhvillimi shoqëror e as nuk kishte pasur ndonjë arritje intelektuale për t'u shënuar. Megjithë gjuhën shumë të zhvilluar të rajonit, me anë të së cilës mund të shpreheshin nuancat më të rafinuara të leksikut, një studim i detajuar i atyre çfarë ka mbetur nga letërsia e tyre, nxjerr në pah shtrirjen e kufizuar të dijeve të tyre. E gjithë kjo ilustron më së miri standardet e tyre të kufizuara të kulturës dhe qytetërimit, natyrën e tyre thellësisht supersticioze, traditat e tyre të egra dhe barbare, si dhe konceptet e tyre primitive dhe degradimin moral.

Ai ishte një vend pa qeveri, ku secili fis deklaronte epërsinë e tij dhe e konsideronte veten të pavarur. I vetmi ligj që njihet ishte ligji i "xhunglës". Zjarrvëniet, plaçkitjet dhe vrasjet e të pafajshmëve dhe të dobtëve ishin në modë. Jeta, prona dhe nderi, ishin përherë të rrezikuara dhe fiset mbanin përherë shpatat ngrehur kundër njëri-tjetrit. Një incident sado i rëndomtë mund t'i fuste në luftëra të egra, që nganjëherë mund të zgjasnin edhe një dekadë dhe t'i vinin zjarrin gjithë vendit. Siç ka shkruar një dijetar:

Këto luftëra shkatërruan sensin e bashkimit kombëtar dhe zhvilluan një ndjenjë separatizmi të pashërueshëm; secili fis e quante veten të vetëmjaftueshëm dhe e konsideronte pjesën tjetër të popullsisë si viktimat e tij të ligjshme, të lejuara për t'i vrarë, skllavëruar dhe plaçkitur¹⁸.

Të paaftë për të dalluar të pastren nga e papastra dhe të ligjshmen nga e paligjshmja, konceptet e tyre për moralin, kulturën dhe qytetërimin, ishin primitive dhe të papërpunuara. Jeta e tyre ishte e egër dhe sjelljet e tyre ishin barbare. Ata ishin të zhytur në imoralitet, kumar dhe pije.

Qëndronin lakuriq përballë njëri-tjetrit pa asnjë ndjenjë turpi dhe gratë silleshin rreth Qabes, Shtëpisë së Shenjtë, të zhveshura.

Prestigji u bënte thirrje për vrasjen e foshnjave femra. Duke u shndërruar në adhures gurësh, pemësh, idhujsh, yjesh dhe shpirtrash, ata i kishin harruar plotësisht mësimet e profetëve të mëparshëm. Ata e kishin njëfarë ideje në lidhje me faktin se Ibrahim dhe Ismaili kishin qenë

paraardhësit e tyre, por pothuajse të gjitha dijet dhe konceptet fetare të këtyre paraardhësve rreth Zotit, i kishin humbur.

Jeta e Muhamedit përpara profetësisë

Ky ishte atdheu i Profetit Muhamed, ku ai lindi në vitin 571. Babai i tij Abdullahu, vdiq përpara se ai të lindte dhe nëna Emineja, vdiq kur ai ishte 6 vjeç. Rrjedhimisht, ai u privua nga çfarëdolloj edukimi apo kujdesi, të cilit i nënshtroheshin fëmijët arabë të asaj kohe. Gjatë fëmijërisë së tij, ai mbeti krejtësisht analfabet dhe i pashkolluar.

Profeti doli jashtë Gadishullit Arab vetëm dy herë. Kur ishte i ri, shoqëroi xhaxhain e tij, Ebu Talibin, në një mision tregtar në Sham (sot Izraeli, Palestina, Libani, Siria dhe Jordania). Hera e dytë ishte kur ai udhëhoqi një mision tregtar në të njëjtin rajon për llogari të vejushës Hatixhe, një tregtare e pasur mekase 15 vjet më e madhe në moshë. Ata u martuan kur ai ishte 25 vjeç dhe jetuan të lumtur së bashku gjersa ajo vdiq, pas më shumë se 20 vjetësh.

Duke qenë analfabet, ai nuk i lexoi ndonjëherë tekstet fetare hebreje dhe kristiane dhe nuk pati asnjë marrëdhënie për t'u shënuar me ta. Traditat dhe idetë e mekasve ishin të orientuar drejt idhujtarisë dhe krejtësisht të pandikuara nga idetë fetare kristiane apo hebreje. Edhe hanifët mekas, të cilët ishin njerëz që pasonin fenë e drejtë të Ibrahimit, por sipas një mënyre të papastër dhe të devijuar dhe që nuk e pranonin idhujtarinë, nuk ishin të ndikuar aspak prej Judaizmit apo Krishtërit. Asnjë ide hebreje apo kristiane nuk është pasqyruar në trashëgiminë poetike të mbijetuar deri në ditët tona të këtyre njerëzve. Në qoftë se Profeti do të kishte bërë ndonjë përpjekje për t'u njohur me të tilla mendime, do të ishte vënë re menjëherë.

Për më tepër, Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), u qëndroi larg trajtave të poezisë dhe retorikës, karakteristike për popullsinë lokale të asaj kohe, edhe përpara profetësisë së tij. Historia nuk shquan ndonjë veçanti të tij ndaj të tjerëve me përjashtim të cilësive të tij morale, besnikërisë, ndershmërisë, besueshmërisë dhe pavarësisë në vendime e veprime. Ai nuk dinte të gënjente dhe kjo është e vërtetuar nga fakti që edhe armiqtë e tij më të betuar, kurrë nuk e kanë quajtur gënjeshtar. Ai fliste me edukatë dhe kurrë nuk përdorte provokimet dhe fjalët abuzive gjatë bisedave të tij. Personaliteti i tij tërheqës dhe sjelljet e mira i bënë për vete zemrat e atyre që takoheshin me të. Ai ndoqi gjithmonë parimin e drejtësisë, altruizmit dhe korrektesës me njerëzit dhe kurrë nuk mashtroi njeri apo i theu premtimet.

Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, u mor me tregti për disa vjet, por kurrë nuk bëri matrapazllëqe. Ata që i lidhte puna me të, kishin besim të plotë te ai dhe në vendimet që ai merrte. Të gjithë e thërrisnin El Emin (i besueshëm). Edhe armiq të tij i linin sendet e tyre të çmuara tek ai me besim të plotë dhe ai në mënyrë të përpiktë e përmbushi përherë detyrën, pra e përligji besimin e tyre. Ai ishte simboli i modestisë në një shoqëri fund e krye jomodeste që nga koka e deri te këmbët. Edhe pse i lindur dhe i rritur mes njerëzve që i konsideronin pijen dhe kumarin si virtyte, ai kurrë nuk piu alkool dhe nuk luajti bixhoz. Edhe pse i rrethuar nga njerëz të pashpirt, zemra e tij ishte e tejmbushur me nektarin e mirësisë njerëzore. Ai ndihmonte jetimët, gratë e veja dhe të varfrit, si dhe ishte mikpritës ndaj udhëtarëve. Ai nuk donte të shqetësonte njeri – ndaj u vu në vështirësi financiare për të ndihmuar të tjerët. Ai ishte në pararojë të punës për pajtimin e mosmarrëveshjeve, duke kapërcyer ndarjet fisnore. Ai kurrë nuk iu përul asnjë krijese dhe nuk mori pjesë asnjëherë në ceremonitë e idhujtarisë, madje as edhe kur qe fëmijë, sepse ai urrente të gjitha llojet e adhurimeve ndaj çdo gjëje tjetër përveç Allahut. Shkurt, ai zotëronte një personalitet rrezatues që kishte zënë vend midis atij ambienti të errët e të ndotur dhe dukej si fanar ndriçues, i cili i jepte dritë një nate të tillë të zezë apo si një diamant në mes të një grumbulli qymyri.

Misioni

Në vitin 610, kur profeti ishte 40 vjeç, një ndryshim i madh ndodhi në jetën e tij. Zemra e tij, e ndriçuar nga Drita Hyjnore, tani e kishte forcën e duhur për t'i shërbyer Atij për të Cilin ajo digjej. Gjatë njërës prej izolimeve të shumta të tij në shpellën Hira, ku shkonte shpesh për meditim, gjatë muajit të Ramazanit, ai mori Shpalljen e parë nga Kryeengjëlli Xhebrail. Xhebraili i tha Muhamedit: “Lexo.” Muhamedi u përgjigj: “Nuk di të lexoj,” meqenëse ai nuk kishte marrë më parë asnjë lloj arsimimi dhe ishte analfabet. Xhebraili pastaj e përqafoi aq fort, sa që Profetit gati iu mor fryma dhe pasi e lëshoi, i tha: “Lexo.” Përgjigjja e Muhamedit ishte e njëjtë si më parë. Xhebraili e përsëriti përqaftimin dhe për të tretën herë, i kërkoi të përsëriste fjalët pas tij dhe tha:

Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që me anë të pendës ia mësoi. Ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.
(Alak 96:1-5)

Atë ditë Muhamedit iu ngarkua misioni i Profetit të fundit, ndaj ai e la shpellën ku izolohej periodikisht, shkoi tek populli i tij dhe i ftoi ata për në Islam.

Për 40 vjet me radhë, Muhamedi jetoi si një njeri i zakonshëm mes popullit të tij. Ai nuk ishte i njohur si udhëheqës, predikues apo orator. Askush nuk e kishte dëgjuar ndonjëherë të mësonte dhe këshillonte njerëzit apo të diskutonte në lidhje me parimet e metafizikës, etikës, ligjit, politikës, ekonomisë apo sociologjisë. Ai nuk kishte ndonjë reputacion si luftëtar, e as nuk ishte i njohur si gjeneral i madh. Ai nuk kishte thënë asgjë më parë në lidhje me Zotin, engjëjt, librat e shpallur, profetët e hershëm, popujt e zhdukur, Ditën e Gjykimit, jetën pas vdekjes, apo për xhenetin dhe xhehenemin. Pa dyshim që ai kishte një karakter të mrekullueshëm dhe sjellje të shkëlqyera, si dhe ishte njeri me takt, por asgjë nuk të shtynte të mendoje se ai mund të ishte njeriu që do të bënte diçka të madhe dhe revolucionare. Ata që e njihnin, e dinin për një njeri të qetë, të matur, serioz, të sjellshëm dhe besnik. Por kur doli nga shpella e Hirasë me një mesazh të ri, ai ishte krejtësisht i shndërruar.

Kur nisi të predikonte, populli i tij e pa me respekt dhe u mahnit nga elokuenca e mrekullueshme dhe aftësia e tij e të bërit për vete. Ai ishte kaq mbresëlënës dhe zemër-rrëmbyes, sa që edhe armiqtë e tij më të mëdhenj kishin frikë ta dëgjonin, duke u trembur se mos ai u mbushte mendjen për të braktisur fenë dhe kulturën e tyre tradicionale. Ligjëratat e tij ishin aq të pakrahasueshme, sa që asnjë poet arab, predikues apo orator, sado i shkathët dhe me përvojë që të ishte, nuk mund të matej me të për gjuhën e mrekullueshme dhe të folurën e shkëlqyer kur ai i ftonte të ndesheshin në këtë fushë. Megjithëse bashkëpunuan me njëri-tjetrin, ata nuk arritën të bënin qoftë edhe një varg që mund të krahasohej me ato që recitonte Muhamedi.

Edhe pse hasi në kundërshtime të menjëhershme dhe të ashpra, ai i përballoi kundërshtarët e tij me buzëqeshje dhe qëndroi i palëkundur ndaj kritikave dhe presioneve të tyre. Kur ata e kuptuan se kërcënimet e tyre nuk e frikësonin këtë njeri të shquar dhe se vështirësitë e mëdha që i shkaktuan atij dhe pasuesve të tij nuk patën efekt, tentuan të përdornin një taktikë tjetër, e cila gjithashtu ishte e thënë të dështonte.

Një përfaqësi e krerëve të kurejshëve (fisit të tij), i ofroi një propozim me synimin për ta korruptuar:

“Nëse do pasuri, ne do të të japim aq sa dëshiron; nëse kërkon nderim dhe pushtet, ne të premtojmë besnikëri si i pari ynë; nëse do bukuri, do të të japim për grua vajzën më të bukur që do të zgjedhësh.”

Këto fjalë ishin tepër joshëse për çdo njeri të zakonshëm, por nuk kishin asnjë vlerë për Profetin. Përgjigjja e tij i ra si bombë përfaqësisë së kurejshëve, të cilët mendonin se kishin hedhur në lojë kartën fituese:

“Unë nuk dua as pasuri, as pushtet. Allahu më ka ngarkuar t’u tërheq vëmendjen njerëzve. Unë përhap mesazhin e Tij ndër ju. Në qoftë se ju e pranoni, do të keni lumturi dhe gëzim në këtë jetë, si dhe bekim të përjetshëm në botën tjetër. Nëse refuzoni, Allahu do të vendosë për ju dhe për mua.”

Në një rast tjetër, ai i tha xhaxhait të tij të cilit i ishte bërë presion nga krerët e fiseve për ta detyruar të hiqte dorë nga misioni i tij:

“O xhaxhai im! Edhe nëse do të më vendosin diellin në dorën time të djathtë dhe hënën në të majtën për të më shtyrë të heq dorë nga ky mision, unë nuk do ta bëja. Unë nuk do të tërhiqem asnjëherë, ose Allahu do të bëjë që ky mision të triumfojë, ose unë do të vdes në këtë përpjekje.¹⁹”

Besimi, qëndrueshmëria dhe vendosmëria me të cilën ai e çoi përpara misionin e ngarkuar drejt suksesit përfundimtar, është një dëshmi e qartë e besimit të tij maksimal në kauzën e vet. Nëse do të kishte edhe fijen më të vogël të dyshimit apo të pasigurisë në zemrën e tij, ai kurrë nuk do të kishte qenë në gjendje të përballonte stuhinë që vazhdoi me tërë furinë e saj 23 vjet rresht.

Angazhimi në thirrje

Personat e parë që pranuan ftesën e Profetit për në Islam qenë Hatixhja, Aliu, Zejd ibn Harithe dhe Ebu Bekri. Ata u ndoqën nga Osmani, Abdurrahman ibn Aufi, Sa’d ibn Ebi Vakkasi, Talha dhe Zubejri. Këta muslimanë të parë e në veçanti Profeti, iu nënshtruan mundimeve të mëdha prej duarve të idhtarëve. Në fakt, shumë muslimanë si p.sh. Jasiri dhe e shoqja Sumeje, u vranë pas torturave të padurueshme.

Qëndresa e këtyre muslimanëve të parë ndikoi së tepërmi në përhapjen e Islamit. Është fakt që gjatë gjashtë viteve të para të profetësisë së tij, burra të fuqishëm si Hamzai dhe Omeri e përqaftuan Islamin dhe e panë veten mes shokëve të Profetit. Sa më shumë rritej numri i atyre që besonin në Islam, aq më shumë shtoheshin pengesat e paganëve, të cilët mundoheshin të parandalonin përhapjen e kësaj feje të re. Në vitin e pestë dhe të gjashtë të profetësisë, disa muslimanë u detyruan nga rrethanat të merrnin leje nga Profeti e të emigronin në Abisini.

Në vitin e shtatë, jobesimtarët i izoluan muslimanët në një zonë të caktuar dhe shpallën bojkotin ndaj tyre. Atyre iu ndalua të bënin tregti, të udhëtonin dhe të kishin kontakte me njerëzit e tjerë. Kjo situatë zgjati për tre vjet me radhë. Në vitin e dhjetë të profetësisë, me vdekjet e

njëpasnjëshme të Hatixhes dhe Ebu Talibit, persekutimi dhe vuajtjet që armiqësitë u shkaktonin muslimanëve, u rrit edhe më tepër. Hatixheja dhe Ebu Talibi ishin njerëz të respektuar në shoqëri, ndaj ky respekt në njëfarë mase i kishte siguruar një shkallë të caktuar imuniteti Profetit.

Profeti vajti në Taif në përpjekje për të siguruar ndopak mbështetje nga jashtë. Por banorët e Taifit, jo vetëm që nuk e pranuan Islamin dhe refuzuan t'i jepnin mbështetje Profetit, por e gjuajtën me gurë dhe ai mezi arriti të shpëtonte, duke u strehuar në një kopsht jashtë Taifit, i mbuluar me gjak. Në lutjen që i bëri Zotit pas gjithë këtyre torturave të tmerrshme, ai tha ndërmjet të tjerave se në qoftë se ishte duke e kryer mirë detyrën, këto tortura s'kishin rëndësi për të. Nuk ka dyshim që ai ka vepruar drejt dhe se e përmbushi misionin e tij plotësisht.

Pavarësisht gjithë këtyre vështirësive, përpjekjet e Profetit Muhamed për përhapjen e Islamit vazhduan. Ai i shtoi edhe më shumë këto përpjekje, duke bërë propagandë nëpër udhëkryqe, ku kalonin udhëtarët që vinin nga jashtë qytetit. Më në fund, një grup prej gjashtë personash që kishin ardhur nga Medina (Jethribi i atëhershëm) për pelegrinazh, dëshmuar vërtetësinë e mesazhit të tij dhe premtuan të plotësonin kushtet e Islamit. Vitin tjetër, pesë veta nga ky grup erdhën së bashku me shtatë njerëz të tjerë nga Medina dhe i dhanë besën Profetit në Akabe. Një besëlidhje e dytë u bë kur shtatëdhjetë e pesë persona, një vit më vonë erdhën nga Medina dhe u zotuan se do ta mbronin Profetin ashtu siç mbronin gratë dhe fëmijët e tyre. Në periudhën që pasoi, me lejen e Allahut dhe pastaj të Profetit, muslimanët që po vuanin së tepërmi në Mekë, emigruan prej aty për në Medinë. Kjo ngjarje njihet si hixhreti në literaturën islame dhe shënon fillimin e kalendarit islam. Të fundit që emigruan qenë Profeti dhe Ebu Bekri. Ky qe një emigrim shumë i vështirë, me paganët mekas që i gjurmonin ata hap pas hapi, që nga shpella e Taurit në jug të Mekës e deri në afërsi të Medinës. Profeti dhe Ebu Bekri patën një udhëtim me shumë peripeci, por në fund ia dolën të mbërrinin në Medinë. Medinasit, ndryshe nga mekasit, e morën në gjirin e tyre Profetin. Ata u bashkuan të gjithë rreth tij dhe i përkrahën pa rezerva ata që kishin lënë shtëpitë e tyre në Mekë për hir të Allahut. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i quan medinasit ensarë (ndihmues), në Kur'an. Është fakt që menjëherë pas emigrimit të profetit u vendos një raport vëllazëror ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve (emigrantëve mekas. Në këtë mënyrë, akti i ndihmesës së njerëzve mori një dimension shpirtëror. Kjo mbështetje ndihmoi të kapërceheshin problemet psikologjike. Emigrantët gjetën mundësinë ta ndanin përvojën e tyre në Islam me medinasit. Ata gjithashtu, hapën dyqane e tregje dhe për një kohë shumë të shkurtër ishin në gjendje të mbanin vetveten. Në këtë mënyrë, emigrantët përfituan nga jeta ekonomike e qytetit.

Të gjitha këto zhvillime i frikësuan paganët në Mekë. Ata dëshironin t'i shkatërronin muslimanët përpara se këta të fundit të forcoheshin më tej. Si rezultat, u zhvilluan luftërat e Bedrit, Uhudit, Lufta e Hendekut dhe Murajsi. Në vitin 630 u mor Meka nga muslimanët. Profeti u rikthye triumfues në qytetin nga ku qe përzënë më parë. Qëllimi i këtij rikthimi ishte pastrimi i Qabes dhe rrethinave të saj prej idhujve dhe kthimi i saj në gjendjen natyrale, siç kishte qenë kur u ndërtua së pari nga Ademi dhe pastaj kur u rindërtua nga Profeti Ibrahim. Profeti nuk u hakmor; ai nuk u mbajti mëri banorëve të Mekës. Përkundrazi, ai shpalli një amnisti të përgjithshme. Ai e shfaqti madhësitinë e tij duke falur kur ishte i fuqishëm. Ai po planifikonte bashkimin, festën e madhe, ndaj nuk kishte kohë për të humbur në çështje ngatërresash fisnore. Prandaj, muezini i Profetit, Bilal el Habeshi, duke kënduar ezanin nga tarraca e Qabes, shpalli epërsinë dhe njësinë e Zotit të Vetëm në qiejt e Mekës.

Fisi kryelartë dhe arrogant i Havazinit, i cili nuk mund t'i kapërdinte kaq lehtë këto ngjarje, thuri plane për frenimin e përhapjes së Islamit, por këto plane rezultuan të pasuksesshme. Ata u mundën në luftë prej muslimanëve. Për rrjedhojë, emri i Islamit kumboi nëpër të gjithë rajonin, duke nisur nga Hixhazi e pastaj nëpër të gjithë Gadishullin Arabik. Brenda një viti që prej kohës kur Profeti u rikthye në Medinë, ai priti e përcolli përfaqësues nga qindra fise.

Në vitin 632 gjatë Haxhit, Profeti (a.s.) foli përpara një turme prej më shumë se njëqind mijë muslimanësh. I njohur si Haxhi i Lamtumirës, ky fjalim qe një përmbledhje e mesazhit të Islamit dhe përbën dokumentin më të përkryer në lidhje me parimet dhe të drejtat e njeriut. Profeti i dashur, i cili qe në gjendje të komunikonte mesazhin që i ishte besuar me shumë përpikmëri falë durimit, vendosmërisë dhe aftësive të tij, i mbylli sytë në këtë botë të hënën më 8 qershor 632.

Cili qe mesazhi i tij?

Profeti Muhamed përkufizohet në Kur'an si "përgëzues dhe paralajmërues". Kur u rikthye tek bashkësia e tij pas marrjes së misionit, ai nisi të luftonte si gjendjen e prishur të njerëzve, ashtu edhe format e devijuara të besimit. Ajo çka i predikoi shoqërisë së tij dhe nëpërmjet saj, njerëzve të të gjithë kohërave, mund të përmbledhet shkurtimisht me këto fjalë:

Idhujt që ju adhuronin janë të rremë, ndaj mos i adhuronin më. Asnjë njeri, yll, pemë, gur apo shpirt nuk duhet të adhurohet nga ju. Mos bini në sexhde para tyre. I gjithë universi i përket vetëm Allahut të Madhëruar. Vetëm Ai është Krijuesi, Ushqyesi, Mbajtësi dhe rrjedhimisht,

Sovrani i vërtetë përpara të Cilit ne duhet të biem në sexhde dhe që është i Denjë për adhurimin dhe bindjen tuaj. Ndaj adhuron vetëm Atë dhe bindiuni urdhrave të Tij.

Vjedhjet dhe plaçkitjet, vrasjet dhe rrëmbimet, padrejtësia dhe mizoria, si dhe të gjitha veset e tjera që keni, janë mëkate në sytë e Allahut. Lëreni rrugën e djallit! Thoni të vërtetën, jini të drejtë! Mos vrisni asnjëri, sepse kushdo që vret një njeri padrejtësisht, është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin dhe kushdo që e shpëton jetën e një njeriu, është sikur të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin (5:32). Mos grabisni asnjëri, por merrni atë që ju takon dhe jepuni të tjerëve atë që u takon ashtu siç duhet.

Mos i bëni shokë Allahut, sepse do të dënoheni dhe do të jeni të braktisur. Nëse njëri nga prindërit tuaj ka arritur moshën e pleqërisë dhe jeton me ju, trajtojeni me respekt dhe jini të mëshirshëm me të. Jepini farefisat atë që i takon. Jepuni nevojtarëve, udhëtarëve dhe mos u bëni shpërdorues. Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë apo për arsye të tjera. Largohuni nga imoraliteti, sepse është vepër e fëlliqur dhe djallëzore. Mos e prekni pasurinë e jetimëve dhe të njerëzve të dobët.

Përmbushini zotimet, sepse do të merreni në pyetje rreth tyre. Mos mashtroni në matje dhe në peshim. Mos ndiqni atë që nuk e njihni, sepse sytë, veshët dhe zemra juaj do të merret në pyetje në lidhje me të. Mos ecni me mendjemadhësi, sepse nuk e keni hapur tokën ju dhe nuk e keni arritur gjatësinë dhe peshën e maleve. Flitini fjalë të mira njëri-tjetrit, sepse djalli i përdor fjalët e ashpra për të futur ngatërresa mes njerëzve. Mos e shtrembëroni fytyrën me përbuzje dhe mos u zemëroni me të tjerët, si dhe mos ecni me pakujdesi nëpër tokë.

Allahu nuk i do ata që mburren, ndaj bëhuni modestë në sjellje dhe mos e ngrini zërin. Mos përqeshni të tjerët, sepse ata mund të jenë më të mirë se ju. Mos u mundoni të gjeni të meta tek të tjerët apo t'i thërrisni me nofka fyese. Largohuni nga shumica e dyshimeve, sepse disa lloj dyshimesh janë mëkate. Mos spiunoni apo përgjoni njëri-tjetrin. Jini pasues të palëkundur të drejtësisë dhe të dëshmisë së drejtë për hir të Allahut, edhe pse ajo mund të jetë kundër jush apo prindërve dhe të afërmeve të tyre, pavarësisht nëse ata janë të pasur apo të varfër. Mos devijoni nga rruga e drejtë duke rendur pas kapriçove tuaja. Bëhuni mbajtës të palëkundur të barazisë për hir të Allahut dhe mos lejoni që urrejtja juaj për të tjerët t'ju mposhtë dhe t'ju bëjë të padrejtë në lidhje me ta.

Frenojeni zemërimin dhe falini fyerjet që ju bëjnë të tjerët. Veprat e mira dhe ato djallëzore nuk janë e njëjta gjë, ndaj shlyeni një vepër të keqe me një të mirë, në mënyrë që të dy palët të mund ta kapërceni armiqësinë tuaj dhe të bëheni miq të ngushtë. Kompensimi për një të keqe që të

bëjnë është një e keqe e po asaj përmase; por kushdo që e fal dhe e përmirëson keqbërësin me mirësi dhe me dashuri, do të shpërblehet nga Allahu. Largohuni nga alkooli dhe lojërat e fatit, sepse Allahu i ka ndaluar ato.

Ju jeni qenie njerëzore dhe të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta përpara Allahut. Askush nuk ka lindur me njollën e turpit në fytyrë apo me shallin e nderit rreth qafës. Njerëzit e vetëm që janë të nderuar dhe të lartësuar, janë njohësit e Allahut dhe të Mëshiruesit, ata që janë të drejtë në fjalë e vepra. Dallimet në lindje dhe lavdia e racës nuk janë kritere madhështie dhe nderi.

Një ditë, pasi të vdisni, do të dilni përpara gjyqit të epërm dhe do të jepni llogari për të gjitha veprat tuaja; asgjë prej tyre nuk do të mund të fshihet. Regjistrimi i jetës suaj do të jetë në një libër të hapur tek Allahu. Fati juaj do të përcaktohet nga punët tuaja të mira e nga ato të këqija. Në gjyqin e Gjykatësit të Vërtetë, Allahut të Gjithëdijshtëm, nuk do të ketë padrejtësi apo mbajtje me hatër. Ju nuk do të mund ta korruptoni Atë dhe raca e prejardhja juaj nuk do të merret parasysh. Vetëm besimi i vërtetë dhe veprat e mira do t'ju bëjnë dobi atë ditë. Ata që i kanë këto me shumicë, do të jetojnë në Parajsë, në lumturi të përjetshme, ndërsa ata që nuk i kanë këto cilësi, do të qëndrojnë përjetësisht në zjarrin e xhehenemit.²⁰

Kur'ani

Kur'ani konsiston në vargje ritmike, fraza, sentenca dhe sure të transmetuara nga Profeti ashtu siç i janë shpallur nga Allahu brenda një periudhe kohore 23 vjeçare dhe për të cilin Profeti deklaroi se ishte mrekullia e përjetshme e profetësisë së tij. Ai i sfidoi arabët e kohës së tij që dyshonin në origjinën hyjnore të Kur'anit, ashtu si edhe të gjithë arabët jobesimtarë dhe joarabët e brezave pasardhës.

Shpalljet hyjnore më të hershme dhe Kur'ani

Një shtyllë tjetër e fesë Islame është edhe besimi në të gjithë Librat Hyjnorë, që Zoti ua shpalli Profetëve të ndryshëm përgjatë historisë së njerëzimit. Zoti ua shpalli Librat e Vet Profetëve të Tij që jetuan përpara Profetit Muhamed, pikërisht në të njëjtën mënyrë. Zoti na informon në Kur'an për disa prej tyre si: Fletushkat e Ibrahimit, Teurati, Zeburi (Psalmet) dhe Inxhili (Bibla). Ne nuk i njohim emrat e librave që iu dhanë Profetëve të tjerë, prandaj nuk mund të themi me siguri nëse atyre u është shpallur që në fillim ndonjë libër apo jo.

Këta Libra Hyjnorë të hershëm, u shpallën në gjuhë tashmë të vdekura, prandaj shumë pak njerëz sot pretendojnë se i kuptojnë. Prandaj edhe sikur këta libra të ekzistonin ende në formën e tyre origjinale dhe të pacënuar, do të kishte qenë virtualisht e pamundur që të kuptoheshin siç duhet dhe urdhëresat e tyre të vireshin në zbatim. Për më tepër, tekstet origjinale të shumicës së këtyre Librave Hyjnorë kanë humbur me kalimin e kohës dhe vetëm përkthimet e tyre mund të gjenden sot. Kur’ani nga ana tjetër, ekziston në gjuhën e tij origjinale, e cila flitet dhe kuptohet ende nga miliona njerëz.

Përkufizimi i Kur’anit dhe disa prej cilësive të tij

Përkufizimi i përgjithshëm i Kur’anit është si vijon: Kur’ani është Fjala e mrekullueshme e Allahut që iu shpall Profetit Muhamed dhe u shkrua e iu transmetua brezave pasardhës me anë të shumë burimeve të besueshme dhe recitimi i të cilit përbën një akt adhurimi të detyrueshëm në lutjet (namazet) ditore.

Kur’ani i përshkruan disa nga veçoritë e tij në këtë mënyrë:

“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja).” (2:185)

“Ky Kur’an nuk është i tillë që të mund të bëhej prej dikujt tjetër veç Allahut. Përkundrazi, ai është vërtetues i shpalljeve të mëparshme dhe shpjegues i Ligjit (për njerëzit) dhe, pa dyshim, është zbritur nga Zoti i botëve!” (10:37)

“Ne e zbritëm këtë Kur’an në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju.” (12:2)

“Në të vërtetë, ky Kur’an udhëzon drejt asaj që është më e vërteta dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se do të kenë shpërblim të madh.” (17:9)

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kur’anin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të merr mësim?” (54:17)

“Se me të vërtetë ky është një Kur’ani i nderuar, në një Libër të ruajtur.” (56:77 – 78)

Kur’ani ka edhe emra të tjerë, çdonjëri prej të cilëve përshkruan një aspekt të tij të veçantë, gjë që mund të konsiderohet si një nga karakteristikat e tij. Disa nga këta emra janë: Libri, Dalluesi, Përkujtuesi, Këshilluesi, Ndriçuesi, Udhërrëfyesi, Shëruesi, i Famshmi, Libri në Vargje, Nëna e Librave, i Vërteti, Këshilluesi, Lajmi i Mirë, Libri i Shpallur Gradualisht, Dituria, si dhe i Qarti.

Profeti thotë: “Kur’ani është më i dashur për Allahun se qiejt dhe toka dhe gjithçka ka mes tyre” dhe “Epërsia e Kur’anit mbi shkrimet dhe ligjëratat e tjera është sikurse epërsia e Allahut mbi krijesat e Tij.”

Kur’ani bën dallimin midis të vërtetës dhe të rremës. Meqenëse ai nuk është shpallur për zbavitje, ata që nuk e pranojnë, do të ndëshkohen. Ai përmban historitë e popujve paraardhës, lajme për brezat pasardhës, si dhe ka rolin e një pajtuesi mosmarrëveshjesh. Ata që e kërkojnë udhëzimin gjetkë, janë në rrugë të shtrembër, sepse Kur’ani është litari i fortë që të lidh me Allahun, është një udhëzues i mençur që të shpie në rrugën e drejtë. Atë nuk është në gjendje ta ndryshojë askush, asnjë gjuhë nuk mund ta ngatërrojë dhe përsëritja e tij nuk i lodh as nuk i mërzit dijetarët, sepse ky libër ka aspekte të admirueshme të panumërta. Të gjithë ata që e dëgjojnë, thonë: “Ne dëgjuam një udhëzim kur’anor drejt së vërtetës, prandaj besojmë në të.²¹” Ata që bazohen tek Kur’ani kur flasin, thonë gjithmonë të vërtetën. Cilido që gjykon sipas tij, gjykon me drejtësi dhe cilido që bën thirrje për t’iu drejtuar atij, bën thirrje për të vërtetën.

Arabishtja, gjuha e shpalljes, përbën trupin e jashtëm të Kur’anit. Feja nuk konsiston vetëm në filozofi apo teologji, por është një mjet bashkimi i të gjitha dimensioneve të qenies sonë. Prandaj arabishtja përbën një element thelbësor dhe të pandarë të Kur’anit.

Kur’ani e sheh botën si djepi i vëllazërimit. Ai synon të bashkojë të gjitha racat, ngjyrat dhe fetë, duke i konsideruar elementët e tyre si vëllezër e motra me njëri-tjetrin dhe si shërbëtorë të Zotit të Vetëm. Gjuha e tij përbën një faktor bazë që i ndihmon njerëzit të soditin realitetet dhe të bashkojnë të gjitha dimensionet e qenies së tyre, në përputhje me standardet hyjnore. Nuk mund të recitohen përkthime të tij gjatë namazeve, sepse asnjë përkthim nuk mund të jetë identik me arabishten origjinale.

Kur’ani është burimi i gjithë dijeve në Islam, qofshin ato dije fetare, shpirtërore, shoqërore, shkencore, morale, ligjore apo filozofike. Si udhëzues drejt të gjitha të vërtetave, ai ka katër qëllime kryesore:

- a) të tregojë Ekzistencën dhe Njësinë e Zotit,
- b) të vërtetojë profetësinë,
- c) të vërtetojë ahiretin (botën e përtejme),
- d) të vendosë themelet e drejtësisë.

Vargjet e tij e vënë theksin mbi këto qëllime; ato përmbajnë parimet bazë të besimit, rregulla që kanë të bëjnë me jetën e njeriut, informacione të detajuara në lidhje me Ringjalljen dhe Ahiretin, udhëzime rreth mënyrës së adhurimit të Zotit, norma morale, informacione të drejtpërdrejta apo tërthore rreth një numri faktesh shkencore, parime të formimit dhe rënies së qytetërimeve, nënvizime rreth fakteve historike në lidhje me qytetërimet e mëparshme dhe shumë e shumë gjëra të tjera.

Kur'ani është një burim shërimi, një kurë e përditshme dhe efikase kundër të gjitha llojeve të sëmundjeve psikologjike dhe shoqërore, por ai në vetvete përmban gjithashtu edhe pjesë nga kozmologjia, epistemologjia, ontologjia, sociologjia, psikologjia, si dhe ligje të shpallura, me qëllim rregullimin e jetës së përditshme të të gjithë njerëzve. Në fakt, Profeti thotë: “Kur'ani është më i dashur për Allahun sesa qiejt e toka dhe gjithçka ka në mes tyre.”²²

Argumente për autorësinë hyjnore të Kur'anit

- Elokuenca, poezia dhe oratoria ishin shumë të zhvilluara në Arabinë paraislamike. Atje zhvilloheshin rregullisht konkurse poezie dhe poemat fituese shkruheshin me gërma të arta dhe vareshin në muret e Qabes. Profeti kurrë nuk është dëgjuar të recitonte qoftë edhe dy vargje të vetme poezie. Megjithatë, Kur'ani i bëri të dorëzoheshin të gjithë ekspertët e njohur të kësaj fushe.
- Edhe jobesimtarët mahniteshin prej tij. Por prapëseprapë, për të ndaluar përhapjen e Islamit, ata thoshin se ai ishte vetëm një magjistar dhe nuk i duhej vënë veshi. Por kur poetë të tillë të shquar të periudhës paraislamike, si Hansa dhe Lebidi, u bënë muslimanë dhe e braktisën poezinë në shenjë respekti dhe përuljeje ndaj stilit dhe elokuencës së Kur'anit, jobesimtarët u detyruan të thonin: “Nëse ne e quajtmë një poemë, ai nuk është i tillë. Nëse e përkufizojmë si një copë proze me rimë, nuk është ashtu. Nëse e konsiderojmë si fjalë e një fallxhori, ai nuk është i tillë.”²³ Hera-herës ata nuk mund të rrinin pa e dëgjuar recitimin e Profetit fshehurazi natën, por nuk mund të kapërcenin dot arrogancën e tyre aq sa të besonin në prejardhjen e tij hyjnore.
- Askush, sado i ditur të jetë, nuk mund të vendosë rregulla aq të plota sa të jetë në gjendje të zgjidhë të gjitha problemet potenciale. Edhe sistemet më të mira shoqërore duhet të rishikohen të paktën një herë në 50 vjet. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, asnjë sistem nuk mund të premtojë lumturi të përgjeshme, sepse parimet e tij janë të kufizuara dhe vlejnë vetëm për këtë jetë

kalimtare, e cila është pambarimisht e shkurtër në krahasim me jetën e pasosur. Nga ana tjetër, asnjë parim i Kur'anit nuk është vjetruar e as nuk ka nevojë për rishikim. Për shembull, në të theksohet se pasuria nuk duhet të qarkullojë vetëm në duart e të pasurve (Hashr 59:7) apo që zyrat e shtetit duhet t'u besohen njerëzve kompetentë dhe të kualifikuar dhe se drejtësia absolute duhet të jetë parimi i vetëm që duhet të udhëheqë administratën publike dhe debatet (Nisa 4:58); se njerëzit mund të kenë vetëm atë për të cilën përpiqen (Nexhm 53:39) dhe se kushdo që vret një njeri pa të drejtë, konsiderohet sikur të kishte vrarë të gjithë njerëzimin (Maide 5:32). Këto dhe shumë parime të tjera (si p.sh. ndalimi i kamatës, bixhozit, alkoolit dhe marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore, ashtu si edhe falja e namazeve, agjërimi, dhënia e lëmoshës dhe sjelljet e mira), janë forcuar nëpërmjet dashurisë dhe vetëdijes për Zotin, premtimit për një jetë të lumtur e të pasosur, si dhe frikës së ndëshkimit në xhehenem.

- Kur'ani gjithashtu zbulon misterin e njerëzimit, krijimit dhe gjithësisë. Kur'ani, njerëzimi dhe gjithësia përbëjnë tre "librat" me anë të të cilëve ne arrijmë të njohim Krijuesin, si dhe janë tri shprehje të së njëjtës të vërtetë. Prandaj Ai që krijoi njerëzimin dhe gjithësinë, shpalli gjithashtu edhe Kur'anin.

- Profeti që një njeri shumë i thjeshtë dhe pa pretendime përse u përket të mirave të kësaj bote, si fama, pushteti politik, pasuria dhe dëshirat trupore. Ai gjithashtu përjetoj periudha të gjata vështirësish dhe persekutimi. Të pretendosh që ai e trilloi Kur'anin, do të thotë të mendosh se Muhamedi i Besueshmi, siç njihej në shoqëri, ishte gënjeshtari dhe mashtruesi më i madh që ka njohur historia. Po përse i qenka dashur të bënte deklarime të rreme rreth profetësisë dhe ta ekspozonte kështu vetveten dhe familjen e tij ndaj gjithë këtyre vuajtjeve dhe persekutimeve? Prandaj këto akuza, ashtu si dhe thëniet sipas të cilave ai e shkroi vetë Kur'anin, janë krejtësisht të pabaza dhe të paarsyeshme.

Regjistrimi dhe ruajtja e Kur'anit

Padyshim Ne e zbritëm Kur'anin dhe padyshim Ne do ta ruajmë atë. (Hixhr 15:9)

Emri i fesë së shpallur nëpërmjet të gjithë profetëve, është Islam. Ashtu siç mbeten të pandryshueshëm ligjet që rregullojnë dhe vënë në lëvizje universin dhe ashtu siç të gjithë njerëzit kanë të njëjtat karakteristika bazë, të njëjtat nevoja themelore dhe të njëjtin përfundim pavarësisht nga vendi dhe nga koha në të cilën jetojnë, edhe për fenë është e natyrshme të jetë e bazuar mbi të njëjtat themele të besimit, adhurimit dhe moralit.

Muhamedi u dërgua si Profeti i fundit dhe me formën e përkryer të fesë hyjnore (Islamit). Allahu e mbron Islamin duke premtuar që ta ruajë Kur'anin. Pasuesit e Musait dhe më vonë ata të Isait, i quajten fetë e tyre respektivisht Judaizëm dhe Krishtërim, ndërsa feja Islame mban emrin e vet origjinal të vënë nga Allahu.

Allahu vepron në këtë botë nëpërmjet shkaqeve natyrore dhe materiale dhe i përdor ato për të ruajtur Kur'anin. Një nga këto është ekzistenca e Kur'anit të shkruar nën mbikëqyrjen direkte të Profetit, në mënyrë që asgjë të mos mund të hiqet, shtohet apo ndryshohet. Të gjitha kopjet e Kur'anit që nga koha e Profetit e deri në ditët tona, janë krejtësisht të njëjta. Ndryshe nga shkrimet e tjera të shenjta, forma origjinale e Kur'anit, teksti dhe gjuha e shpalljes, janë ruajtur dhe ne i kemi sot ato nëpër duar. Prandaj pikat e mëposhtme kanë një rëndësi të konsiderueshme:

- Kur'ani u shpall në pjesë dhe Allahu mori përsipër ruajtjen e tij, duke bërë ndërtimin e tij në vargje dhe sistemimin e pjesëve të tij. Ai i tregoi Profetit se ku duhen vendosur ajetet dhe suret e ndryshme.

“Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kur'anit me gjuhën tënde.

Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë.

Dhe kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij.

Pastaj e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë atë.” (75:16-19)

“I lartësuar qoftë Allahu, Sunduesi i Vërtetë. Ti mos nxito për ta lexuar Kur'anin para se të përfundojë shpallja e tij dhe thuaj: “O Zoti im, shtoma dijen.” (20:114)

- I Madhëruari thotë se asnjë falsitet nuk mund ta prekë Kur'anin dhe se asnjë dyshim i hedhur mbi të, nuk mund ta cënojë autenticitetin e tij.

“Ata që e mohojnë Fjalën Përkujtuese (Kur'anin), kur u vjen, do të dënohen rëndë; Ai është vërtet një libër i madhërueshëm. Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej të Urtit, që meriton të gjitha lavdet. (41:41-42)

- Një herë në vit, i Dërguari i Allahut e rishikonte gjithë atë që i ishte shpallur së bashku me kryeengjellin Xhebrail. Në vitin e fundit të jetës, pasi u plotësua shpallja, Xhebraili erdhi dy herë për këtë qëllim. I Dërguari i Allahut nga kjo nxori përfundimin se së shpejti do të vdiste.

Që nga fillimet e shpalljes, Sahabët bënë të pamundurën ta kuptonin, mbanin mend dhe ta mësonin Kur'anin. Në fakt, ishte Kur'ani ai që i urdhëroi të vepronin ashtu:

“Kur të lexohet Kur'ani, dëgjojeni (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni.”
(7:204)

Allahu i Madhëruar deklaroi: “Ne e kemi për detyrë t'i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë.”
(Kijame 75:17) Ajetet dhe suret e Kur'anit u mbledhën dhe u sistemuan në përputhje me udhëzimet e Profetit (kur ai ishte ende gjallë), i cili udhëzohej nga shpallja. Versioni zyrtar u formua pas Betejës së Jemames. Kur ndodhi një mosmarrëveshje në lidhje me shqiptimin e disa fjalëve të caktuara, versioni zyrtar u kopjua dhe u dërgua nëpër qendra të rëndësishme gjatë kohës së kalifatit të Osmanit (644-56).²⁵

Një nga arsyet kryesore që Kur'ani ka mbetur i pandryshuar, është ruajtja në gjuhën e tij origjinale. Askush në botën muslimane nuk e ka çuar nëpër mend ta zëvendësojë atë me një përkthim, ndaj ai nuk është përballur asnjëherë me rrezikun e përkthimeve të pasakta e të gabuara, apo shtesave dhe heqjeve të pjesëve.

Pra përfundimisht, mund të themi se Kur'ani që mbajmë sot në duar është i njëjti Kur'an të cilin Profeti e mori nga Allahu. Papësëritshmëria dhe gjenialiteti i tij është i padiskutueshëm. Asnjë dijetar musliman i çfarëdo grade nuk e ka vënë kurrë në dyshim këtë dhe askush nuk ka dyshuar ndonjëherë për faktin se çdo fjalë që gjendet në Kur'anin e sotëm, është komunikuar nga Profeti.

Qytetërimi Islam

Gjatë Mesjetës (e njohur në historinë evropiane si Epoka e Errësirës), një qytetërim i mrekullueshëm po shndriste në Lindjen muslimane. Duke iu bindur udhëzimeve të Kur'anit, muslimanët e studiuin këtë Libër të Shpalljes Hyjnore, si dhe Librin e Krijimit (gjithësisë) dhe në këtë mënyrë, themeluan qytetërimin më të mahnitshëm të gjithë historisë së njerëzimit. Dijetarë nga mbarë bota përfituan nga qendrat e arsimit të lartë në Damask, Buhara, Bagdad, Kajro, Marok, Kairavan, Zeitona, Kordoba, Siçili, Isfahan, Delhi e mjaft vende të tjera përgjatë botës muslimane. Historianët e krahasojnë botën muslimane të asaj periudhe me një kohë bletësh, për faktin se rrugët ishin plot me studentë, shkencëtarë dhe dijetarë të cilët udhëtonin nga njëra qendër arsimore tek tjetra. Figura të tilla të njohura në mbarë botën si al Kindi, al Havarizmi, al

Farabi, Ibni Sina, ibn Hejthem, al Biruni, Gazali, al Mas'udi, Tusi, al Zahravi etj., ndriçuan si yje në qiellin e shkencës.

Në librin e tij me shumë vëllime të titulluar “Hyrje në historinë e shkencës (1927-48)”, Xhorxh Sarton e ndau punimin e tij në periudha 50 vjeçare, duke e titulluar secilin kapitull sipas emrit të shkencëtarit më të shquar të asaj periudhe. Qysh nga mesi i shekullit të tetë e deri në shekullin e dymbëdhjetë pas Krishtit, secila prej këtyre periudhave 50 vjeçare mbart emrin e një shkencëtari musliman, si p.sh. “Periudha e al-Havarizmit,” “Periudha e al-Birunit” e kështu me radhë. Brenda këtyre kapitujve, Sarton rendit 100 shkencëtarë muslimanë të rëndësishëm, si dhe titujt e veprave të tyre kryesore. Po kështu edhe Xhon Davenport, një shkencëtar i shquar, vëren:

Duhet të pranohet se të gjitha dijet në fizikë, astronomi, filozofi apo matematikë që ndriçuan Evropën qysh nga shekulli i dhjetë, e kishin burimin nga shkolla arabe dhe saraçenët spanjollë mund të konsiderohen si baballarët e filozofisë evropiane.²⁶

Bertrand Rasëll, filozofi i famshëm britanik, ka shkruar:

Supremacia e Lindjes nuk ishte vetëm ushtarake. Shkenca, filozofia, poezia dhe artet, që të gjitha lulëzuan në botën e Muhamedanëve, në një kohë kur Evropa ishte zhytur në barbarizëm. Evropianët, për shkak të izolimit të tyre të pafalshëm, e quajtën këtë periudhë “Epoka e Errësirës”; por e vërteta është se vetëm Evropa ishte në errësirë (madje vetëm Evropa Kristiane), sepse Spanja që ishte Muhamedane, kishte një kulturë të shkëlqyer.²⁷

Robert Briffault, historiani i njohur, pohon në librin e tij “Ngjallja e njerëzimit”:

Ka të ngjarë që po të mos kishin qenë arabët, qytetërimi modern evropian nuk do të kishte qenë kurrë në gjendje të merrte atë karakter që e bëri të aftë të kapërcente gjithë fazat e mëparshme të evolucionit. Por ndonëse nuk është vetëm njëri nga aspektet e veçanta të zhvillimit njerëzor ai në të cilin influenca vendimtare e kulturës Islame është e pallogaritshme, është e qartë dhe shumë e rëndësishme të theksohet se në gjenezën e asaj fuqie që ishte forca lëvizëse e botës moderne, qëndronte shpirti shkencor dhe pasioni për shkencat e natyrës. Ajo që ne e quajmë shkencë, lindi në Evropë si rezultat i një shpirti të ri hulumtimesh, i metodave të reja të vëzhgimeve, i metodave eksperimentale, studimeve, matjeve, i zhvillimit të matematikës në një formë të panjohur më parë për grekët. Ky shpirt dhe këto metoda u futën në botën evropiane nga arabët.²⁸

L. Stoddard pohon se në pesë shekujt e para pas lindjes së saj, mbretëria e Islamit ishte zona më e qytetëruar dhe më përparimtare e botës. E zbukuruar me qytete të mrekullueshme, xhami

madhështore, si dhe me universitete komode, Lindja muslimane paraqiste një kontrast të dukshëm me Perëndimin, që ishte i zhytur në natën e Epokës së Errësirës.²⁹

Ky qytetërim i ndritur, përparoi derisa pësoi fatkeqësi të tmerrshme që erdhën si dallgë të stërmëdha shkatërruese, siç ishin Kryqëzatat Evropiane (1097-1270) dhe Pushtimi Mongol (1216-58). Këto fatkeqësi dhe shkatërime vazhduan për shekuj me radhë, derisa qeveria muslimane në Bagdad ra (1258) dhe historia e Islamit hyri në një fazë të re në shekullin e XIII me turqit osmanë. Qytetërimi Islam ishte ende i fuqishëm dhe qëndroi në ballë të qytetërimeve të tjera në fushën ekonomike dhe atë ushtarake deri në shekullin e XVIII, pavarësisht se (që nga shekulli i XVI e më pas) humbi terren në shkencë.

Në shekullin e X-të, Kordoba muslimane ishte qyteti më i përparuar evropian, mrekullia dhe admirimi i mbarë botës. Udhëtarë nga veriu dëgjonin për qytetin që kishte plot 70 biblioteka me qindra mijëra tituj librash dhe me 900 banjo publike. Kurdoherë që sunduesve të Leonit, Navarrës, apo Barcelonës u nevojitej një kirurg, arkitekt, rrobaqepës apo muzikant, ata kontaktonin me Kordobën.³⁰ Prestigji i letërsisë muslimane ishte aq i madh në Spanjë saqë Bibla dhe liturgjitë kishtarë do të përktheheshin në arabisht edhe për komunitetin autokton kristian. Fragmenti i mëposhtëm i shkruar nga Alvaro, një shkrimtar kristian i devotshëm, tregon qartë se si edhe spanjollët jomuslimanë i kishte bërë për vete letërsia arabo-muslimane:

Shokët e mi kristianë frymëzohen nga poemat dhe romanët e arabëve. Ata studiojnë veprat e teologëve dhe filozofëve muhamedanë jo për t'i përgënjeshtruar, po për të përvetësuar një stil korrekt dhe elegant të arabishtes. E ku mund të gjesh vallë sot një njeri laik që të lexojë komentet në latinisht të Shkrimeve të Shenjta? Cili është ai që studion sot Ungjijtë, Profetët, Apostujt? Asnjëri! Përkundrazi, kristianët e rinj, që janë më të dalluarit për talentin e tyre, nuk kanë asnjë njohuri në ndonjë lloj tjetër letërsie apo gjuhe përveç asaj arabe; ata lexojnë dhe studiojnë me etje libra arabisht; ata krijojnë biblioteka të kushtueshme me të tillë libra dhe gjithmonë i këndojnë liturgjitë me fjalë arabe.³¹

Në qoftë se pranojmë që qëllimi i edukimit arsimor dhe i qytetërimit është të rrisë shkallën e krenarisë, dinjitetit dhe nderit të njerëzve që ata të përmirësojnë gjendjen e tyre e rrjedhimisht edhe gjendjen e shoqërisë, atëherë duhet të pohojmë se qytetërimi Islam ka dhënë prova për vlerën e tij. Shumë shkrimtarë kanë shfaqur mendimet e tyre në lidhje me aftësinë e Islamit për të transformuar shoqëritë me të cilat ai bie në kontakt. Për shembull, në ligjëratën e tij rreth efekteve dhe ndikimit të Islamit tek njerëzit, të mbajtur në Kongresin Kishtar të Anglisë, Isaac Taylor tha:

Kur përqafohet Muhamedanizmi, atëherë paganizmi, fetishizmi, vrasja e fëmijëve dhe magjia e zezë zhduken. Ndyrësia zëvendësohet nga pastërtia dhe të konvertuarit e rinj fitojnë dinjitet dhe respekt për vetveten. Ballot mondane dhe marrëdhëniet jo të rregullta seksuale ndërpriten, dëlirësia femërore çmohet si virtyt, industria zëvendëson parazitizmin, zbatimit të ligjit i jepet përparësi, mbizotërojnë rregulli dhe serioziteti, çrrënjosen hasmëritë dhe mizoria ndaj kafshëve e skllëvërve. Islami i fshin korrupsionin dhe bestytnitë. Islami është një revoltë ndaj polemikave boshe. Ai iu dha shpresë skllëvërve, vëllazëri njerëzve dhe përbën një njohje të plotë të të vërtetave bazë në lidhje me natyrën njerëzore. Virtytet që Islami ngulit tek njerëzit janë vetëpërmbajtja, pastërtia, dëlirësia, drejtësia, forca morale, kurajoja, dashamirësia, mikpritja, besnikëria dhe toleranca. Islami predikon një vëllazëri praktike, barazinë shoqërore të të gjithë muslimanëve. Skllavërimi nuk është pjesë e besimit Islam. Poligamia përbën një çështje më të ndërlikuar. Moisiu nuk e ndaloi atë. Ajo është praktikuar nga Davidi dhe nuk është drejtpërdrejt e ndaluar nga Testamenti i Ri. Muhamedi e kufizoi të drejtën për poligami pa kufi. Ajo përbën më tepër një rast të veçantë sesa një rregull të përgjithshëm. Me nënshtrimin ndaj Vullnetit të Zotit, me vetëpërmbajtjen, pastërtinë, besnikërinë dhe me vëllazërinë ndërmjet tyre, ata (muslimanët) na japin një shembull që do të bënim mirë ta ndiqnim. Islami i ka ndaluar dehjen, imoralitetin dhe prostitucionin, tre mallkimet e vendeve kristiane. Islami ka bërë më tepër sesa kristianët për qytetërimin. Bërja për vete e një të tretës së botës nga ana e fesë së tij (Muhamedit), ishte një mrekulli.³²

Besimi – Gjashtë KUSHTET

- Një Zot i Vërtetë
- Engjëjt
- Librat – Shkrimet e shenjta
- Profetët
- Dita e gjykimit – Llogaridhënia
- Paracaktimi Hyjnor (Kaderi)

I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, po kështu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij dhe të dërguarve të Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”, dhe thanë: “E dëgjuam thirrjen tënde dhe u bindëm. Faljen tënde kërkojmë, o Zoti ynë dhe te Ti do të jetë kthimi ynë.” (Bekare 2:285)

Besimi ose imani në arabisht, ka kuptimin e pohimit me anë të arsyes dhe të bindjes në zemër që nuk ekziston Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Imani përfshin edhe besimin se ekziston një jetë e pasosur pas kësaj bote dhe se i gjithë njerëzimi do të merret në pyetje në Ditën e Gjykimit; gjithashtu, përfshin edhe të besuarit në ekzistencën e engjëjve, të cilët veprojnë si shërbëtorë të Zotit, si dhe të besuarit se ekziston një Përcaktim dhe Vendim Hyjnor në bashkëveprim me vullnetin e lirë të njerëzve.

Besimi përbën në vetvete nënshtrimin ndaj Qenies së Vetme Supreme, Allahut të Madhëruar dhe çlirimin e vetvetes nga nënshtrimi ndaj epsheve. Ai është bindja se kozmosi nuk është një produkt përfundimtar i dukurive të rastësishme natyrore, por shenjë e drejtpërdrejtë që tregon Krijuesin. Besimi rrit aftësinë mendore për të “reflektuar,” në mënyrë që çdokush të kuptojë manifestimin e Emrave dhe Cilësive të Allahut të shfaqura në gjithësi. Besimi i sinqertë manifestohet si nga ana e brendshme, me anë të nënshtrimit të zemrës, ashtu edhe nga ana e jashtme, me anë të kryerjes së riteve të faljeve dhe adhurimit.

Gjashtë kushtet e besimit, apo siç njihen ndryshe edhe gjashtë shtyllat e besimit, janë gjashtë çështjet në vijim, me anë të të cilave një besimtar duhet të ruajë besimin e tij:

1. Një Zot i Vetëm i Vërtetë (Allahu)
2. Engjëjt
3. Librat (Shkrimet Hyjnore)
4. Profetët
5. Ringjallja dhe Ahireti
6. Paracaktimi Hyjnor (Kaderi)

Një Zot i Vetëm i Vërtetë

“A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata thanë: “Po, dëshmojmë se Ti je!” (Araf 7:172)

Islami i drejtohet natyrës fillestare dhe i bën thirrje njerëzimit të sjellë ndërmend pohimin e dhënë përpara krijimit, siç theksohet në ajetin kur'anor të mësipërm. Çdo qenie njerëzore lind në këtë botë me natyrën e tij të pastër, ndaj ai ose ajo udhëhiqet në mënyrë të natyrshme drejt besimit në realitetin e një Zoti të Vetëm.

Realiteti i Zotit i cili është i Vetëm, i Përhershëm dhe Absolut, përbën thelbin e besimit Islam. Zoti qëndron mbi çdo dualitet dhe shoqërim, mbi ndryshimet gjinore dhe mbi çdo cilësi që i dallon qeniet nga njëra-tjetra në këtë botë. Gjithashtu, Ai është burimi i gjithë ekzistencës dhe i të gjitha cilësive kozmike dhe njerëzore, ashtu siç përbën edhe Pikën Përfundimtare tek e cila çdo gjë rikthehet.³³ Një nga ajetet kur'anore më të lexueshme, Ajeti Kursi, rendit disa nga Emrat dhe Cilësitë kryesore të Allahut, me anë të të cilave Ai e ka bërë Vetveten të njohur në krijim:

Allahu! Nuk ka Zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përhershmit. Atë nuk e kaplon as dremitja as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Sundimi i Tij përfshin qiejt dhe tokën dhe ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është më i Larti, më i Madhështori!

Islami pohon Njeshmërinë e Zotit dhe sundimin e Tij të pandashëm mbi gjithësi. Zoti është Krijuesi, Mjeshtri, Mbajtësi i gjithçkaje që ekziston. Gjithçka funksionon sipas planit të Tij. Ai ka shpallur nëpërmjet Profetëve të Tij Rrugën e Drejtë për udhëheqjen e njerëzimit. Të gjithë profetët (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta), kanë predikuar të njëjtin mesazh:

Ne nuk nisur asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur se: Nuk ka Zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni! (Enbija 21:25)

Profetët i ftuan burrat dhe gratë të bënin një jetë të karakterizuar nga virtytet, pastërtia, drejtësia dhe paqja, dhe të vepronin sipas udhëzimeve që Ai kishte shpallur.

Të gjithë profetët, duke filluar që nga Ademi, Nuhu (Noah), Ibrahim (Abrahami), Musai (Moisiu), Isai (Jezusi) dhe deri tek Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta) predikuan të njëjtën fe të karakterizuar nga pranimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut dhe thirrja për paqe. Dështimet njerëzore qëndrojnë në mosmbrojtjen dhe mosruajtjen e mësimave të profetëve të hershëm.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, u dërgua për të risjellë mesazhin original, për ta paraqitur atë në formën e vet të përkryer dhe për ta ruajtur në një mënyrë të tillë që fjala e Zotit të mos ngatërrohej më me fjalët e njerëzve.

Asnjë send nuk është si Ai. (Shura 42:11)

Ky ajet i shkurtër thekson faktin që Allahu nuk është i të njëjtit lloj me ato që Ai ka krijuar, prandaj Ai qëndron përtej të gjitha përfytyrimeve njerëzore rreth Tij. Ndaj dhe Ai nuk ka shokë, asgjë nuk i ngjason Atij, Ai as nuk lind e as nuk ka lindur prej ndokujt. Asgjë, qoftë lëndë, hapësirë ose kohë, nuk mund ta kufizojë ose ta frenojë Atë. Kjo është arsyeja përse cilësitë e Tij, ndërmjet të cilave janë Dëgjimi, Shikimi, Dijet, Vullneti, Fuqia, Krijimi e kështu me radhë, qëndrojnë gjithashtu përtej gjithçkaje që ne mund të perceptojmë.

Profeti Muhamed u pyet njëherë nga bashkëkohësit e tij në lidhje me Zotin; përgjigjja erdhi direkt nga vetë Zoti në formën e një sureje të shkurtër të Kur'anit, e cila konsiderohet si thelbi i Njeshmërisë apo motoja e monoteizmit:

Thuaj: Ai, është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjyerohet gjithçka në amshim. Ai as ka lindur kënd, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Të. (Ihlas 112:1-4)

Allahu është i Dashur, i Bukur dhe i Drejtë. Me përjashtim të njërës, secila prej 114 sureve të Kur'anit, fillon me frazën: “Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.” Profeti thotë: “Allahu është më i dashur dhe i dhembshur sesa një nënë për fëmijën e saj të dashur.” Por Zoti është gjithashtu edhe i Drejtë.

Islami nuk e pranon karakterizimin e Zotit në ndonjë formë njerëzore apo mendimi, sipas të cilit Ai favorizon individë ose popuj të caktuar mbi baza pasurie, pushteti apo race. Ai i krijoi qeniet njerëzore të barabarta. Ato mund ta dallojnë vetveten dhe të fitojnë favoret e Tij vetëm nëpërmjet virtyteve dhe përkushtimit.

Engjëjt

Besimi në mbretërinë e padukshme të ekzistencës dhe në qeniet që e popullojnë atë, përbën një shtyllë tjetër të besimit Islam. Meqenëse shqisat tona janë të kufizuara, nuk përbën zgjuarsia

mohimi apriori i ekzistencës së botëve përtej perceptimit nga shqisat tona. Për më tepër, ne dimë shumë pak rreth ekzistencës dhe ajo që njohim është një pjesë shumë e vogël në krahasim me atë që nuk njohim ende. Konceptet tona rreth natyrës dhe universit janë ende në fazat e tyre fillestare, ndaj nuk mund të deklarojmë se dimë gjithçka që do të ndodhë në të ardhmen. Shkencat tona gjenden ende në fazën e tyre të “foshnjërisë” dhe e ardhmja do të jetë dëshmitare e zbulimeve dhe zhvillimeve shkencore të paimagjinueshme. Konceptet Islame në lidhje me krijimin, shpalljen, profetësinë, ngjarjet që ndodhin në botë, adhurimin, jetën shpirtërore, vdekjen, ringjalljen dhe pozitën qendrore të gjinisë njerëzore në kozmos, nuk mund të kuptohen pa iu referuar engjëjve.

Ndërtuesi i Madhërishtëm i pallatit gjigant të krijimit, ka përdorur për këtë qëllim katër lloje ose kategori punëtorësh: engjëjt dhe qeniet e tjera shpirtërore, sendet pa shpirt dhe krijesat bimore të cilat janë shërbëtorë të rëndësishme të Zotit, që punojnë pa u shpërblyer, kafshë të cilat i shërbejnë pa ndërgjegje Atij në këmbim të një sasive të vogël ushqimi dhe kënaqësie, si dhe njerëzit të cilët punojnë me vetëdije dhe të ndërgjegjshëm për qëllimet e Krijuesit të Madhërishtëm. Njerëzit mësojnë nga çdo gjë dhe janë mbikqyrës të shërbëtorëve të rangut të ulët (siç janë kafshët, bimët, etj.) dhe në këmbim, ata do të shpërblehen këtu dhe në Ahiret.

Engjëjt janë krijuar prej “dritës,” jo prej asaj drite që ne njohim, por prej dritës në një formë më të rafinuar dhe të dobët të cilën ne e quajmë nur. Fjala arabe që përkufizon engjëjt është melek. Duke pasur parasysh rrënjën e kësaj fjale, melek ka kuptimin “i dërguar,” “përfaqësues,” “i ngarkuar,” “mbikqyrës” dhe “i fuqishëm.” Kuptimi i kësaj rrënje gjithashtu shpreh zbritjen nga një vend i lartë. Engjëjve u është dhënë njëfarë lirie veprimi, por ndryshe nga njerëzit, ata nuk sprovohen. Pozita e tyre në sytë e Allahut nuk ndryshon kurrë. Engjëjt janë shërbëtorë të Zotit, që ndërtojnë marrëdhëniet ndërmjet botës metakozmike dhe asaj materiale, përcjellin urdhrat e Zotit, drejtojnë veprat dhe jetët e gjallesave (me lejen e Zotit), si dhe kryejnë adhurimin që u takon të bëjnë në botën e tyre.

Këto qenie nuk ngrihen kurrë në pozitë për atë që bëjnë, sepse secili prej tyre ka një gradë të fiksuar dhe të përcaktuar dhe është në gjendje të fitojë një kënaqësi të veçantë nga puna e vet, ashtu siç është në gjendje të marrë ndriçim nga adhurimi. Prandaj shpërblimi i tyre gjendet në shërbimin që bëjnë. Ashtu si ne që, duke u ushqyer, marrim kënaqësi nga ajri, uji, drita dhe ushqimi, edhe engjëjt ushqehen dhe marrin kënaqësi nga drita e mirënjohjes, lavdërimit, adhurimit, përkujtimit dhe dashurisë për Allahun. Meqenëse ata janë krijuar nga drita në formën e saj më të rafinuar dhe të dobët, është drita ajo që i mban gjallë. Edhe parfumet erëmirë,

ekzistenca e të cilëve është e lidhur ngushtë me dritën, përbëjnë një burim ushqimi të pëlqyer për ta.

Nga puna e tyre e kryer nën komandën e Atij që e adhurojnë, nga veprat e tyre për hir të Tij, nga shërbimi i kryer në Emër të Tij, nga mbikëqyrja nën vështirimin e Tij, nga nderimi i fituar për shkak të lidhjes me Të, për shkak të ripërtëritjes së tyre duke studiuar përmasat materiale dhe jomateriale të Mbretërisë së Tij dhe për shkak të kënaqësisë që marrin gjatë vëzhgimit të manifestimit të Madhërisë dhe Bujarisë së Tij, engjëjt janë në gjendje të fitojnë një lumturi aq të madhe, saqë ne nuk jemi në gjendje ta imagjinojmë dot. Për më tepër, vetëm ata mund ta përjetojnë një lumturi të tillë.

Engjëjt nuk gënjejnë dhe nuk janë të pabindur, sepse ata nuk kanë një shpirt të komanduar nga djalli apo ego së cilës i duhet rezistuar. Ata kanë pozitën e tyre të fiksuar, prandaj as nuk u ngrihet e as nuk u ulet grada. Ata gjithashtu, janë të çliruar nga cilësi të tilla negative si zilia, mëria dhe armiqësia, si dhe nga të gjitha llojet e grykësive dhe orekseve shtazore, të cilat gjenden te qeniet njerëzore dhe te xhindët. Ata nuk kanë gjini, nuk hanë e nuk pinë dhe nuk ndjejnë as uri, as etje e as lodhje. Lutjet, adhurimet, përmendja e Emrave të Allahut dhe lavdërimi i Tij, përbëjnë ushqimin e tyre, ashtu si edhe drita e aromat.

Engjëjve u janë ngarkuar detyra të caktuara. Krahës detyrës së tyre për të përfaqësuar dhe për të mbikëqyrur gjallesat e ndryshme në tokë dhe për t'i shprehur adhurimin e tyre Allahut, ekzistojnë katër kryeengjëjt dhe engjëjt të tjerë, të cilët kanë funksione të veçanta dhe afërsi të veçantë tek Allahu. Xhebraili është dërguesi i shpalljeve të Allahut, Mikaili ka për detyrë administrimin e shiut, rritjen e bimëve dhe ruajtjen e vendeve të shenjtë, Israfil ka për detyrë t'i fryjë surit (bririt) për të lajmëruar Ditën e Ringjalljes ndërsa Azraili është ai që merr shpirtrat e njerëzve në momentin e vdekjes.

Ekzistojnë edhe grupe të tjerë engjëjsh, siç janë: Mele'i A'la (Këshilli i Lartë), Nadij-i A'la (Përfaqësia e Lartë) dhe Refik-i A'la (Shoqëria e Lartë), ashtu siç ekzistojnë edhe engjëjt që kryejnë detyrat e tyre në Parajsë (xhenet) dhe në Ferr (xhehenem). Engjëjt që regjistrojnë veprat e një njeriu të caktuar, quhen Kiramun Katibun (regjistruesit fisnikë). Munkiri dhe Nekiri marrin në pyetje shpirtrat e të sapovdekurve. Një hadith thekson se ekzistojnë 360 engjëjt që janë përgjegjës për jetën e çdo besimtari; ata kujdesen për të veçanërisht gjatë fëmijërisë dhe pleqërisë, luten për të dhe i kërkojnë Allahut ta falë; të tjerë engjëjt kanë për detyrë të ndihmojnë besimtarët gjatë luftërave, mbikëqyrin aktivitetet që kanë për qëllim falenderimin dhe lavdërimin e Allahut, ashtu siç vëzhgojmë edhe grupimet e krijuara për hir të Allahut dhe për dobinë e njerëzve.

Librat – Shkrimet e shenjta

Islami e rendit besimin në të gjithë Librat Hyjnorë të shpallur nga Allahu nëpërmjet profetëve të Tij, si një shtyllë të rëndësishme të fesë. Muslimanët besojnë që Zoti ua shpalli njerëzve Shkrimet e Shenjta të Tij si një mjet udhëzimi për ta. Kur’ani është libri i fundit të cilin Allahu ia shpalli Profetit Muhamed. Allahu ka garantuar që Kur’ani do të mbrohet nga çdo ndryshim apo shtrembërim, prandaj asnjë material i huaj nuk i është shtuar dhe asnjë shkronjë e vetme nuk është hequr nga teksti i Kur’anit. Qysh nga momentet e para të shpalljes, Kur’ani është mësuar me gjithë shpirt nga shumë muslimanë dhe është ruajtur në formën e shkruar.

Muslimanët besojnë se ndërmjet librave të shpallur nga Allahu, bëjnë pjesë edhe Teurati i Musait a.s. (Tora e Moisiut), Inxhili i Isait a.s. (Bibla e Jezusit), Zeburi i Davudit a.s. (Psallmet e Davidit), Pllakat e Shkrimit të Ibrahimit a.s. dhe në fund Kur’ani.

Kur’ani nuk është thjesht një libër që njësohet me Biblën, megjithëse ekzistojnë shumë pika të përbashkëta ndërmjet tyre. Një prej ndryshimeve thelbësore midis tyre është se librat origjinalë të Biblës, sot nuk ekzistojnë më në formën dhe gjuhën në të cilën u shpallën fillimisht dhe vetëm disa përkthime të saj mund të gjenden sot në qarkullim. Nga ana tjetër, asnjë përkthim i Kur’anit nuk mund të konsiderohet si Kur’an i mirëfilltë, sepse një përkthim i tij thjesht quhet “studim i kuptimit të Kur’anit.” Çdokush që ka bërë përkthime e di që një shkallë e caktuar e interpretimit humbet në përkthim dhe se vetëm një person që e njeh mirë gjuhën origjinale mund ta kufizojë këtë ndryshim interpretimi deri në shkallën më të vogël të mundshme. Është absolutisht e domosdoshme që një përkthyes të ketë njohuri të shkëlqyera të arabishtes, në mënyrë që përkthimi i Kur’anit të jetë sa më i përshtatshëm. Sot ekzistojnë shumë përkthime të Kur’anit, me anë të të cilave besimtarët mund të lexojnë dhe të kuptojnë mesazhet e tij.

Një pikë tjetër e rëndësishme që duhet theksuar në lidhje me Kur’anin, është se ai nuk është në vetvete një libër historie, shkence apo ligjesh, megjithëse i përmban të gjithë këta përbërës; ai është së pari dhe kryesisht një libër i udhëzimeve hyjnore. Gjithashtu, ju duhet ta dini se Kur’ani nuk përmban shpjegime të hollësishme në lidhje me situatat që gjeneruan shpalljen e ajeteve të tij.

Më së shumti, ajetetet përmbajnë linja orientimi dhe parime të përgjithshme. Ato gjithashtu japin sihariqe për të mirët dhe shprehin paralajmërime për ata që janë në rrugë të gabuar. Ato

përmbajnë një numër rrëfimesh që shërbejnë si paralajmërime, thirrje dhe tërheqje vërejtjeje për njerëzit në përgjithësi. Në disa raste, Kur'ani gjithashtu jep udhëzime të veçanta.

Kur'ani u shpall gjatë periudhës 23 vjeçare të karrierës profetike të Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi të, në përputhje me kërkesat e konteksteve të veçanta, të cilat bënë thirrje për udhëzim hyjnor në çështje të caktuara. Për këtë arsye, nëse duam të arrijmë tek kuptimi i saktë i shumë prej ajeteve të tij, neve na duhet të njohim rrethanat në të cilat këto ajete janë shpallur. Është gjithashtu e rëndësishme të ritheksohet edhe një herë se Profeti nuk ishte autori i Kur'anit. Kur'ani, ashtu si edhe librat e tjerë të shpallur, është fjala e Allahut, e cila erdhi në formën e një serie mesazhesh pjesë-pjesë dhe jo si një rrëfim në vijimësi.

Profetët

Ne dërguam tek çdo popull një profet. (16:36)

Njëlloj si tek Judaizmi dhe Krishtërimi, profetësia është një koncept i rëndësishëm në Islam. E ndërsa Njeshmëria e Zotit përbën themelet ideologjike të Islamit, koncepti i administrimit të tokës nga ana e njeriut përbën kornizën vepruese në kuptimin e pikëpamjeve Islame në lidhje me krijimin e qenieve njerëzore, si dhe qëllimin e tij.

Megjithëse Kur'ani përmend me emër vetëm 25 profetë, Zoti na e bën të qartë që Ai i ka dërguar shumë profetë njerëzimit. Nuk ekziston asnjë fis, popull apo racë tek i cili Zoti të mos ketë dërguar Udhëzimet e Tij. Një numër prej 124 mijë profetësh përmendet në një nga hadithet e Profetit Muhamed (historitë rreth Dhulkarnejnit, Llukmanit dhe Uzejrit gjithashtu përmenden në Kuran, megjithëse profetësia e tyre nuk është e shprehur qartë).

Profetët më të mëdhenj (Ulul adhm – mjeshtrit e vendosmërisë), janë: Nuhu (Noah), Ibrahim (Abrahimi), Musai (Moisiu), Isai (Jezusi) dhe Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të gjithë ata.

Një tipar dallues i besimit Islam në lidhje me profetësinë, është se muslimanët i besojnë dhe i respektojnë të gjithë të dërguarit e Allahut, pa asnjë përjashtim. Meqenëse të gjithë profetët u dërguan nga i njëjti Zot i Vetëm dhe për të njëjtin qëllim – për ta udhëhequr njerëzimin drejt rrugës së Zotit – besimi në të gjithë ata është thelbësor dhe logjik.

Besimi në të gjithë profetët e Zotit, përbën një prej shtyllave të fesë Islame. Megjithëse hebrenjtë nuk i njohin Jesusin e Muhamedin dhe kristianët nuk e njohin Muhamedin, muslimanët i pranojnë të gjithë ata si të Dërguar të Zotit, të cilët i sollën udhëzimet e Zotit njerëzimit. Mohimi

i profetësisë së ndonjërës prej figurave të së shkuarës, do ta zhvlerësonte besimin e një muslimani dhe ai ose ajo, në këtë rast, nuk do të konsideroheshin më muslimanë.

Historia e Ademit dhe Havasë gjendet në shumicën e traditave fetare e kulturore. Mënyra sipas së cilës Kur'ani e rrëfen këtë ngjarje, përbën një pikë kyçe për të kuptuar pikëpamjet islame. Në vija të përgjithshme, Kur'ani e rrëfen këtë ngjarje në këtë mënyrë: Allahu e deklaroi qëllimin e Tij për të dërguar një mëkëmbës të Tij në tokë. Ai i krijoi Ademin dhe Havanë nga e njëjta lëndë. Ata ishin planifikuar të luanin këtë rol prej mëkëmbësi prej Allahut në tokë dhe ishin pajisur me njohuri rreth sendeve për ta kryer detyrën e tyre ashtu siç duhej. Ata u vunë në provë duke u porositur të mos i afroreshin një peme të caktuar. Ata ranë viktimë e nxitjeve të mbrapshta të djallit dhe iu afruan pemës. Por menjëherë pas këtij gabimi u penduan, përfituan faljen e Allahut dhe iu shlye gabimi.

Është e rëndësishme të theksohet se vetëm pasi u falën dhe u rehabilituan, ata u dërguan në tokë për të luajtur rolin e tyre si mëkëmbës të Allahut. Atyre u ishte premtuar Udhëzimi Hyjnor dhe u ishte garantuar se ata që ndiqnin këtë udhëzim, do të ishin të suksesshëm. Prandaj, Ademi që njeriu i parë që mori këtë lloj udhëzimi dhe ua bëri të qartë pasardhësve të tij, duke u bërë kështu profeti i parë i Zotit.

Nga kjo nxjerrim disa rrjedhime të rëndësishme. Islami nuk e pranon teorinë e “rënies në mëkat të Ademit” që simbolizon rënien në mëkat të njerëzimit që në momentin e lindjes. Njerëzit u krijuan me qëllimin e vetëm që është veprimtaria si përfaqësues të Zotit në tokë, prandaj ata erdhën në botë për të përmbushur këtë mision. Historia e Ademit dhe Havasë përfaqëson ngritjen e njerëzimit në një nivel të ri dhe jo rënien e tij.

Megjithatë, konceptet e përfaqësisë dhe profetësisë nuk duhen ngatërruar. Roli dhe statusi i përfaqësisë u është besuar të gjitha qenieve njerëzore, ndaj ai ka të njëjtën vlerë si për burrat, ashtu edhe për gratë.

Islami në këndvështrimin e tij, e përshkruan natyrën njerëzore si një bilur të bardhë të cilësisë së lartë në pritje për t'u gdhendur. Njerëzimi është krijuar në formën më të përkryer dhe çdo njeri lind në një gjendje pastërtie dhe pafajësie të plotë. Për më tepër, njerëzve u është dhënë liria për të zgjedhur. Ata janë të lirë ta pranojnë ose ta mohojnë të vërtetën. Çdo person mban përgjegjësi për veprimet e tij, por atij nuk i mohohet kjo liri edhe në qoftë se abuzon me të, sepse në të kundërt kjo do të përbënte kufizim të kësaj lirie. Rreziqet që vijnë nga keqpërdorimi i lirisë, vazhdimisht i konfrontojnë njerëzit, sepse përpjekjet e djallit nuk marrin fund asnjëherë. Sprova e Ademit dhe Havasë, nga njëra anë shfaq mirësinë në thelb të natyrës së tyre dhe nga ana tjetër

prirjen për të rënë lehtësisht pre e gabimeve. Për të ruajtur krijesat njerëzore prej këtij rreziku, Allahu ka bërë të mundur sigurimin e udhëheqjes hyjnore nëpërmjet profetëve dhe të Dërguarve të Tij.

Profetët ishin që të gjithë qenie njerëzore. Ata kishin të njëjtat cilësi sikurse edhe njerëzit e tjerë, hanin, flinin, martoheshin apo sëmureshin. Megjithatë, kishin disa karakteristika të veçanta që i dallonin, si besnikëria (sidk), amaneti, zgjuarsia (fetanet), aftësia për të komunikuar mesazhe hyjnore (teblig), pagabueshmëria (ismet), etj. Profetët i zotëronin këto cilësi në shkallën më të lartë gjatë jetës së tyre. Ata u pajisën edhe me aftësinë për të bërë mrekulli, për të provuar kështu se nuk ishin mashtrues. Mrekullitë e tyre u bënë të mundura me anë të fuqisë dhe lejes së Zotit dhe zakonisht ndodhnin në fushën në të cilën komuniteti ku ata ishin dërguar, e ndjente veten superior. Secili prej profetëve e ka shprehur qartë se çdo gjë të veçantë që ai kishte, i ishte dhënë vetëm prej Zotit për të mirën e njerëzimit. Ata pohonin ato që ishin shpallur përpara dhe ato që do të shpalleshin pas tyre. Në këtë kuptim, mesazhi ishte i njëjtë në thelb dhe synonte tek i njëjti qëllim.

Thelbi i përmbajtjes së mesazheve të profetëve ishte adhurimi i Zotit të Vetëm ashtu siç kishte urdhëruar Ai, si dhe porositja e njerëzve për të kryer vepra të mira gjatë jetës së tyre. Është e mundur të përpunohen ide që ndryshojnë sipas detajeve të caktuara në lidhje me natyrën e Zotit dhe ligjet e Tij, në varësi të çdo rasti individual që ka lidhje me një profet të caktuar. Islami kategorikisht e hedh poshtë konceptin e “shenjtërisë” së ndonjërit prej profetëve. Ata janë në thelb qenie njerëzore dhe megjithëse janë të mbrojtur nga mëkatet, mund të bëjnë edhe ndonjë gabim të vogël.

Një zbatim i plotë i fesë është i pamundur vetëm me anë të shkrimeve të shenjta; nevojitet patjetër një i dërguar, i cili përbën një mjet komunikimi të shpalljes për njerëzimin. Transmetimi i mesazhit nuk arrihet vetëm nëpërmjet shprehjes së mesazheve hyjnore me fjalë, por gjithashtu duke u shndërruar vetë në modelin më të mirë të mundshëm për t’u ndjekur, në të cilin besimtarët mund të shohin një shembull të qartë në lidhje me mënyrën se si mesazhet e Zotit duhen kuptuar dhe praktikuar. Një shembull konkret në lidhje me këtë, janë edhe namazet në Islam, që përbëjnë një shtyllë kryesore të jetës dhe praktikës islame dhe të cilat i janë bashkangjitur Kur’anit. Megjithatë, muslimanët kanë mësuar se si t’i kryejnë ato nëpërmjet praktikës së profetit, meqenëse në Kur’an mënyra e kryerjes së namazeve nuk përshkruhet me detaje.

Profetët e përmendur si në Kur'an, ashtu edhe në Bibël, janë: Ademi, Idrizi (Enoch), Nuhu (Noah), Ibrahim (Abraham), Ismaili (Ishmael), Is'haku (Isaac), Jakubi (Jakob), Jusufi (Josef), Ejubi (Job), Musai (Moisiu), Haruni (Aroni), Dhulfikli (Ezekiel), Davudi (Davidi), Sulejmani (Solomon), Iliasi (Elijah), Eljesai (Elisha), Junusi (Jonah), Zekerija (Zechariah), Jahja (Gjon Pagëzori), Isai (Jezusi).

Ringjallja dhe Ahireti

Besimi në jetën pas vdekjes është aq i domosdoshëm në fenë Islame, saqë çdo dyshim në lidhje me të, barazohet me mohimin e Zotit. Vetë fjala e Zotit në Kur'an është themeli i këtij besimi. Për më tepër, Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, e ka shpjeguar rëndësinë e kësaj shtylle të besimit për një person që dëshiron të ketë një jetë të udhëhequr nga parimet islame.

Ne e dimë se nuk kemi asnjë mjet për të identifikuar jetën pas vdekjes si një përvojë të përjetuar. Por Zoti na ka dhënë një nivel të caktuar ndërgjegjeje, e cila na garanton që nëpërmjet anës shpirtërore, të hyjmë në realitete që nuk mund të perceptohen me anë të shqisave. Kur'ani i drejtohet racionalitetit të mendjes sonë kur i përgjigjet pyetjes së mosbesimtarëve: “Kush do t’u japë jetë eshtrave të kalbura?” Përgjigja është: sigurisht Ai që i ka krijuar ato.

Në Kur'anin e Shenjtë, Allahu i bën thirrje arsyes njerëzore dhe i drejtohet fuqisë sonë të mendimit dhe të gjykimit, duke na thënë të mendojmë rreth faktit se si shiu e gjallëron trupin e vdekur. Kjo është diçka e dukshme për ne, prandaj si është e mundur që ta mohojmë të vërtetën e ringjalljes, kur Allahu i Madhëruar mundet që me po atë lehtësi me të cilën ringjall tokën, mund të ringjallë edhe eshtrat e kalbura.

Allahu është Ai që i dërgon erërat, të cilat lëvizin retë. Ne i drejtojmë ato në viset e vdekura e, nëpërmjet tyre gjallërojmë tokën, pasi ka qenë e shkretë. Ja, kështu do të jetë edhe ringjallja. (Fatir 35:9)

Kur'ani në mënyrë të përsëritur na tregon se si ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të shpërblehen gjerësisht në ahiret, ndërsa ata të cilët nuk besojnë dhe bëjnë vepra të këqija, do të ndëshkohen.

Besimi në jetën pas vdekjes i jep kuptim jetës sonë, sepse Ai na e bën të qartë se kjo jetë është vetëm një sprovë dhe përgatitje për jetën e pasosur. Për më tepër, ne e dimë se në Ahiret ne do të marrim të drejtën që na takon për të gjitha padrejtësitë që kemi vuajtur këtu. Në pamje të parë mund të duket se mëkatarët dhe të korruptuarit shpesh janë më të lumtur apo më të pasur sesa njerëzit e ndershëm, por kjo situatë zgjat vetëm për një kohë të shkurtër. Në Ahiret ata do të marrin ndëshkimin që u takon.

Besimi në jetën pas vdekjes e nxit një person të bëjë një jetë të rregullt në tokë, sepse ai e njeh fatin që e pret nëse shpërfill urdhrat dhe paralajmërimet e Allahut të shkruara në Kur'an. Në fakt, besimi në jetën pas vdekjes është një stimul i fuqishëm për një person, që ai të bëjë një jetë të virtytshme në këtë botë. Rruga e vërtetë drejt një shoqërie paqësore, mund të shtrohet vetëm nëse njerëzit besojnë në jetën pas vdekjes.

Paracaktimi Hyjnor, Kaderi

Një musliman duhet të besojë në Paracaktimin Hyjnor apo Kaderin në arabisht. Koncepti i Caktimit Hyjnor i përdorur në Kur'an nënkupton një përmasë apo mundësitë e fshehta me të cilat Allahu i krijoi qeniet njerëzore dhe gjithçka tjetër që ekziston në natyrë. Kur Allahu i krijoi sendet, Ai përcaktoi se kur ato do të vijnë në ekzistencë dhe kur do të pushojnë së ekzistuari. Ai gjithashtu përcaktoi dhe cilësitë dhe natyrën e tyre. Gjithçka në gjithësi qoftë e dukshme apo e padukshme, është krejtësisht subjekt i pushtetit absolut të Allahut. Asgjë nuk mund të ndodhë jashtë Vullnetit të Tij.

Përsa u përket qenieve njerëzore, ato nuk janë plotësisht zotër të fateve të tyre, por as kukulla në duart e fatit. Zoti u ka dhënë njerëzve pushtet të kufizuar dhe liri të madhe, duke përfshirë edhe lirinë e zgjedhjes. Kjo autonomi e bën secilin individ përgjegjës për veprimet e tij.

Ne nuk e njohim të ardhmen tonë dhe në një masë të madhe, nuk mund ta kontrollojmë dot. Por megjithatë, mund të marrim vendime për çështje që ndodhen brenda kufijve të asaj çfarë mund të kemi nën kontroll, duke u bazuar mbi kuptimin tonë rreth mënyrës se si funksionon bota. Në qoftë se dikush vendos të godasë me grusht një mur tulle, ai nuk mund të ankohet për padrejtësi kur plagos dorën. Ai e di që muri ekziston dhe se është i fortë. Ky është realiteti – “ligjet e natyrës” – me të cilat i duhet të ballafaqohet. Megjithatë, e vërteta është që Zoti është në gjendje ta zhdukë murin përpara se ta arrijë grushti.

Meqenëse Zoti krijoi natyrën dhe ligjet e saj, Ai caktoi edhe rregullat morale, prandaj ne nuk mund të ankohemi për padrejtësi në qoftë se ndëshkohemi për mosbindje apo shpërfillje të këtyre ligjeve morale.

Në këtë mënyrë, koncepti i kaderit është një tregues që na e bën të qartë se duhet të kërkojmë harmoninë me ligjet e Allahut, që kanë të bëjnë me natyrën njerëzore dhe me natyrën në përgjithësi, dhe me ndërgjegje duhet t'i bindemi vullnetit të Tij. Megjithatë, kaderi sipas konceptit Islam, nuk na e heq të drejtën e zgjedhjes dhe veprimeve. Është zgjedhja jonë me vullnet të plotë për veprimet që kryejmë duke u nisur nga mundësitë tona të natyrshme, të cilat janë në harmoni me vullnetin e Zotit, ajo që na bën të fitojmë shpërblimin tonë nga Allahu.

Megjithëse Allahu ka vendosur disa rregulla të caktuara në Paracaktimin e Tij, në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve, edhe këto mund të ndryshohen nëpërmjet lutjeve. Profeti thoshte se vetëm lutësit e sinqertë mund të ndryshojnë rrjedhën e ngjarjeve që do të ndodhin dhe se adhurimi i vërtetë dhe nënshtrimi i sinqertë ndaj Allahut, mund ta ngrenë besimtarin mbi ligjet e zakonshme të natyrës. Personat që luten mund të kenë rezultat në ngjarje të konsideruara si “mrekulli personale”, të cilat përbëjnë ndodhi apo përjetime që ne i konsiderojmë pothuajse të pamundura ose krejtësisht të pamundura.

Nga këndvështrimi Islam, qeniet njerëzore janë të lira për të kryer çdo veprim në praktikë. Një person nuk mund të shfajësohet për faktin se ka bërë një zgjedhje të gabuar dhe pastaj t'ia hedhë fajin kaderit, sepse si në rastin e shembullit të mësipërm, kur njeriu i bie me grusht murit, ai nuk mund të fajësojë ligjet e natyrës. Ai i di pasojat e veprimit të tij në praktikë dhe nuk mund të presë të ndodhë një mrekulli!

Ne nuk duhet të shqetësohemi se çfarë ka shkruar Allahu për ne, sepse nuk mund ta dimë kurrë këtë. Por detyra jonë është të përpiqemi të bëjmë më të mirën, si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën. Pastaj, nëse dëshiron Allahu, rezultatet pozitive do të vijnë.

Ndërsa përsa i përket çështjes a janë njerëzit të paracaktuar për të hyrë në Parajsë (xhenet) apo Ferr (xhehenem), duhet të rikujtojmë që për Allahun nuk ekziston koncepti kohë. Ai është i Gjithëdijshmi i së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes. Prandaj Ai e di qysh më përpara cilën rrugë – të mirë apo të keqe –do të zgjedhë secili individ dhe cili do të jetë stacioni përfundimtar i tij – xheneti apo xhehenemi. Por një njohje e tillë nuk nënkupton që Ai i bën njerëzit të zgjedhin një rrugë të caktuar. Të dish diçka përpara se të ndodhë nuk është e njëjta gjë me bërjen të mundur që ngjarja të ndodhë. Determinizmi absolut nuk ka lidhje me veprimet e njerëzve. Për shembull, le të shohim analogjinë e mëposhtme: autorët kanë dijeni të plota dhe të sakta rreth

librit që do të shkruajnë dhe i sistemojnë kapitujt, faqet, paragrafët, fjalitë dhe fjalët përpara se ta shkruajnë atë. Në këtë kuptim, kaderi ka kuptimin pak a shumë të njëjtë me Dijen Hyjnore, ose është një titull i Dijes Hyjnore. Prandaj ai quhet gjithashtu “Tabela Supreme e Ruajtur” (Lehvi Mahfudh). Kaderi gjithashtu nënkupton që Allahu bën gjithçka sipas një mase të veçantë e të përcaktuar, si dhe në baraspeshën e duhur:

“Allahu e di se ç’bart çdo femër dhe e di sa shkurtohet e sa zgjatet koha e lindjes. Tek Ai, çdo gjë është me masë të caktuar.” (Rra’d 13:8)

Dielli dhe hëna ndjekin rrugën e caktuar. Edhe yjet edhe bimët i përulen (Allahut). Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën. Që ju të mos e shkelni atë. Prandaj matni drejt e mos hani në peshë! (Rrahman 55:5-9)

Praktikimi- Pesë shtyllat

- Dëshmia e Besimit (shehadeti)
- Namazi
- Agjërimi i Ramazanit
- Zekati
- Haxhi

"Islami është i ndërtuar mbi pesë shtylla, të cilat janë: dëshmia se nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Tij, falja e pesë vakteve të namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i muajit të Ramazanit, si dhe kryerja e Haxhit në Qabe, për ata që kanë mundësi."34

Dëshmia e Besimit (shehadeti)

Shehadeti, fjala arabe që nënkupton deklarimin e Islamit apo shprehjen e besimit, nga pikëpamja gjuhësore ka kuptimin e “të qenit dëshmitar për diçka.” Dëshmia e besimit përbën aktin e parë të hyrjes në Islam, sepse katër shtyllat e tjera, janë në një farë mënyre “deklarimet e zbatuara” apo “besim i zbatuar në praktikë.” Shehadeti është shprehja bazë e Islamit, e cila përmbledh pohimin

se “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Tij.” Kushti i të qenit musliman, përcaktohet thjesht nga një shqiptim i sinqertë i kësaj dëshmie, me anë të së cilës, një person “bëhet dëshmitar” i ekzistencës së Allahut dhe i faktit se nuk ekziston asnjë Zot tjetër përveç Tij që duhet adhuruar dhe i profetësisë së Muhamedit, duke përqafuar në këtë mënyrë Islamin si fe të vërtetë dhe mënyrë jetese. Pavarësisht shkurtësisë dhe thjeshtësisë së saj, kjo dëshmi bën thirrje për ndryshim në mënyrën se si një person e koncepton kozmosin dhe vetveten. Në vend që gjithçka t’ia atribuojë natyrës, fatit apo vetes së tij, kur bëhet musliman, një person i nënshtrohet Vullnetit të Allahut me ndërgjegje të plotë, vullnet të lirë dhe me të drejtën e zgjedhjes, kështu që ai është i ndërgjegjshëm për nënshtrimin vullnetar të tij ndaj Allahut.

Një person konsiderohet musliman sapo shqipton këtë frazë. Megjithatë, “qenia dëshmitar” në thelb nuk përbën vetëm një pohim verbal që bëhet vetëm një herë. Të gjithë njerëzit, duke përfshirë edhe muslimanët, nxiten për të mbajtur besimin e tyre të freskët duke rikujtuar vazhdimisht këtë pohim gjatë rrjedhës së jetës së tyre. Kur’ani u bën thirrje muslimanëve që e kanë deklaruar besimin e tyre dhe e praktikojnë, të mos pushojnë së përpjekuri në rrugën e besimit.

O ju që besuat! Besoni Allahun, të Dërguarit të Tij, Librit që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librit që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librave e Tij, të Dërguarit e Tij dhe botën tjetër, ai me të vërtetë ka humbur larg prej udhës së drejtë. (Nisa 4:136)

Në të vërtetë, feja nuk konsiston thjesht në një pohim, pranim apo dëshmi. Ashtu sikurse ekzistojnë nivele të panumërta dhe gradë të ndryshme në shfaqjen e diellit, që nga shfaqjet e dritës dhe nxehtësisë së tij në të gjitha sendet në tokë, nën efektin e pasqyrimin të rrezeve në hënë dhe pastaj tek vetvetja, në të njëjtën mënyrë edhe besimi mbart në vetvete nivele dhe shkallë të panumërta, duke filluar që nga perceptimi i thjeshtë i bazuar mbi arsyen dhe pohimin në zemër, e deri tek gradët e depërtimit në të gjitha pjesët dhe degët e trupit që ai kontrollon, si dhe shkallët që drejtojnë gjithë jetën e një personi – duke filluar që nga besimi i një njeriu të zakonshëm e deri tek besimi maksimal, karakteristikë e profetëve. Grada apo niveli i parë i fesë, është thjesht besimi në themelet e përmendura në ajetin e mësipërm; pastaj, vjen zgjerimi gradual i besimit dhe qëndrimi i palëkundur në të. Kjo është arsyeja përse Kur’ani zakonisht urdhëron apo ndalon diçka pas adresimit me fjalët: “O ju që besuat!” Një dëshmi e plotë besimi kërkon bindje ndaj këtyre urdhrave, gjë që i bën ata të jenë më të fortë dhe më në brendësi të besimit.

Besimi në thelb është bindja e zemrës; megjithatë, për integrimin e dëshiruar brenda shoqërisë muslimane, është e këshillueshme të deklarohet besimi përpara syve të dëshmitarëve. Kështu, një

musliman i ri përfiton mbështetje dhe ndihmë nga bashkësia, në mënyrë që besimi i tij të rritet dhe të stabilizohet.

I Dërguari i Allahut ka thënë: Cilido që dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është Robi dhe i Dërguari i Tij dhe se Isai (a.s.) është robi i Allahut dhe i biri i një gruaje e cila ishte shërbëtorja e Tij dhe se ishte fjala e Tij ajo që e ngjizi atë tek Merjemja dhe Ai i dha shpirt, dhe se xheneti është i vërtetë dhe xhehenemi është i vërtetë, Allahu do ta fusë atë në xhenet nga cilado prej dyerve që ai dëshiron (në përputhje me veprat e tij).” 35

Në një rast, Profeti ishte ulur dhe po rrinte në një kopsht. Ai i tha njërit prej sahabeve të tij: “Kur të takosh ndokënd jashtë këtij kopshti që të dëshmojë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut duke qenë i bindur me zemër për atë që thotë, jepi atij sihariqin e parajsës”36

Në një rast tjetër, i Dërguari i Allahut tha: “Allahu ia ka ndaluar zjarrin e xhehenemit cilitdo që thotë ‘Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut’ (La ilahe i’lallah), duke kërkuar në këtë mënyrë kënaqësinë e Allahut.”37

Namazet – Adhurimet ditore

Adhurimet ditore ose namazet, përbëjnë praktikën qendrore që modelon rutinën e përditshme dhe ndërgjegjen e një muslimani. Çdo namaz konsiston në një seri pozicionesh, në të cilat recitohen pjesë nga Kur’ani dhe Allahut i shprehen falenderime, gjatë të cilave besimtari lutet. Qëllimi parësor i namazeve është të brumosë individin me instinktin e përkujtimit të Zotit. Zoti thotë në Kur’an:

Fale namazin për të më kujtuar Mua. (Ta-ha 20:14)

Përkujtimi i Allahut e ushqen zemrën. Ai është një mjet efikas për të arritur lumturinë. Allahu thotë:

Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Zotit. (Rra’d 13:28)

Kur zemra bie në grackën e lënies pas dore të Allahut, djalli merr kontrollin e saj, mëkatet bëhen tërheqës dhe besimi dobësohet. Ilaçi për këtë është përkujtimi i Allahut.

Ti lexo atë që të është zbritur ty prej Librit (Kur'ani) dhe fale namazin. Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar; dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve); Allahu di gjithçka që ju bëni. (Ankebut 29:45)

Muslimanët falen pesë herë në ditë. Falja në kohë të ndryshme i shmang njerëzit nga fokusimi i plotë në nevojat e tyre të çastit që kanë lidhje me këtë botë. Ato përbëjnë një përkujtim për faktin se Allahu është Garantuesi, Mbështetësi dhe Plotësuesi i të gjitha nevojave tona. Namazi është i detyrueshëm për çdo musliman të shëndetshëm, i cili ka arritur moshën e pjekurisë. Por është më mirë që fëmijët të nxiten të fillojnë më herët t'i përgatisin zemrat e tyre për të.

Një nga simbolet e Islamit, ezani, është pjesa që përfaqëson thirrjen për në namaz. Duke kënduar vargjet e mëposhtme, muezini i thërret muslimanët në xhami për t'u falur. Ezani përbëhet nga këto fjalë:

Allahu ekber (Zoti është më i Madhi): katër herë

Eshhedu en la ilahe ilallah (dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut): dy herë

Eshhedu enne Muhameden Resulullah (dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut): dy herë

Hajje ales salah (ejani në namaz): dy herë

Hajje alel felah (ejani në shpëtim): dy herë

Allahu ekber (Zoti është më i Madhi): dy herë

La ilahe ilallah (s'ka Zot tjetër përveç Allahut): një herë

Koha e namazit të parë (sabahu), fillon rreth një orë e gjysmë përpara lindjes së diellit. Ai është një moment kur trupi dëshiron të flejë. Për të kapërcyer plogështinë në mënyrë që të ngrihemi dhe të përkujtojmë Krijuesin, nevojitet një luftë kundër egos. Për këtë, shërben me mjaft efikasitet, të stërviturit e vetvetes me anë të nënshtrimit ndaj vullnetit të Allahut. Ky namaz përbëhet prej katër rekateve; grupi i parë i përbërë nga dy rekate quhet namazi sunet dhe grupi tjetër prej dy rekatesh quhet namazi farz (i detyrueshëm).

Koha për namazin e dytë të ditës (dreka), vjen rreth kohës kur një person e ndalon punën për të ngrënë drekë (të paktën për pjesën më të madhe të njerëzve në botë), pikërisht pasi dielli e arrin zenitin e tij. Krahas ushqimit të trupit, çdo njeri duhet të ushqejë edhe shpirtin e tij. Ky namaz përbëhet prej dhjetë rekateve; grupi i parë prej katër rekatesh përbën namazin sunet, i pasuar nga katërshja tjetër që është namazi farz, si dhe një grup tjetër prej dy rekatesh, që përbën një namaz tjetër sunet.

Namazi i tretë (ikindia), kryhet në mes të kohës ndërmjet mesditës dhe perëndimit të diellit, pak a shumë në momentin kur njerëzit zakonisht janë duke pirë ndonjë kafe apo duke u kthyer në shtëpi nga puna. Ai përbëhet nga tetë rekate; një grup prej katër rekatesh përbën sunetin dhe grupi tjetër prej katër rekatesh përbën namazin farz.

Namazi i katërt (akshami), kryhet në perëndim të diellit, në një kohë kur shumica e njerëzve janë duke ngrënë darkë. Ai përbëhet prej pesë rekatesh. Grupi i parë prej tre rekatesh përbën namazin farz dhe grupi i tjetër prej dy rekatesh, sunetin.

Namazi i pestë (jacia), kryhet në një kohë kur njerëzit janë duke u përgatitur për të fjetur. Ai përbëhet prej dhjetë rekateve; grupi i parë prej katër rekatesh përbën namazin sunet, i pasuar nga një grup prej katër rekatesh që përbën namazin farz, pastaj nga një grup tjetër prej dy rekatesh që përbën një namaz tjetër sunet. Një namaz tjetër shtesë i quajtur vitri falet pas namazit të jacisë. Ai është një namaz vaxhib (i domosdoshëm) dhe përbëhet prej tre rekateve.

Një person që dëshiron t'i falë këto namaze, duhet të jetë fizikisht i pastër. Ekzistojnë dy mënyra për t'u konsideruar i pastër në Islam: larja e plotë (gusli) dhe abdesti.

Larja e plotë (gusli)

I gjithë trupi, duke përfshirë edhe vrimat e hundës, gojën dhe kokën, duhet të lahet krejtësisht përpara se të hyhet në namaz, në këto raste:

- Menjëherë pas rënies në shehadet (d.m.th. pasi një person ka përqafuar Islamin)
- Pas marrëdhënieve seksuale
- Pas derdhjes së spermës
- Pas periudhës së menstruacioneve

- Në fund të periudhës së caktuar për gratë lehona (d.m.th. maksimalisht dyzet ditë pas lindjes)

Është gjithashtu shumë e këshillueshme të merret gusël të paktën një herë në javë nëse nuk ka mundësi për më tepër, veçanërisht përpara namazit të xhumasë dhe të Bajramit.

Si një pjesë e pandarë e çdo akti të adhurimit dhe praktikimit të besimit, është edhe vetëdija e plotë në lidhje me qëllimin (nijeti) që duhet bërë në fillim të larjes, me qëllim që të përcaktohet se ajo larje po bëhet për arsye pastrimi për adhurim. Profeti, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, merrte gusël në këtë mënyrë:

- Merret abdes (njëlloj si për namaz, por me një përjashtim: Profeti e shtynte larjen e këmbëve deri në fund të guslit.
- Duhet hedhur ujë mbi kokë tri herë, duke e lënë ujin të depërtojë deri tek rrënjët e flokëve (nëse flokët janë mbledhur në formë gërsheti, nuk ka nevojë që gërsheti të zgjidhet për sa kohë që uji mund t'i lagë krejtësisht ato).
- Duhet larë të dy duart nga tri herë.
- Duhet larë pjesët intime, si dhe rrënjët e flokëve.
- Duhet shpëlarë i gjithë trupi, duke filluar nga ana e djathtë, pastaj e majta, pastaj nënsqetullat, pjesa e brendshme e veshëve, kërthiza, pjesa e brendshme e gishtave të këmbës dhe çfarëdo pjese tjetër e trupit, e cila mund të arrihet lehtë nga uji.

Abdesti

Hapi i parë që duhet hedhur për të falur një namaz, është marrja e abdestit. Ky përbën një akt pastrimi shpirtëror dhe fizik dhe duhet kryer përpara fillimit të namazeve farze apo atyre sunete.

Abdesti është një procedurë mjaft e thjeshtë dhe kryerja e tij paraqitet në formë të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Tejemumi – Abdesti simbolik me dheun e pastër

Kjo është një formë pastrimi që mund të kryhet në vend të abdestit ose guslit kur mungon uji, në rast se uji është i papastër dhe i rrezikshëm për shëndetin, ose në rast se marrja e abdestit ose guslit do të bënin që ju të humbisni një namaz xhenazeje apo Bajrami (këto namaze nuk mund të zëvendësohen apo të falen më vonë).

Tejemumi merret thjesht duke prekur lehtë me duar dheun e pastër, rërën, ndonjë gur apo mur dhe pastaj duke i fërkuar pëllëmbët me njëra-tjetrën në mënyrë që të shkunden papastërtitë. Pastaj fërkohet fytyra me duar, më pas përsëri preket toka dhe fërkohen krahët deri tek bërrylat, duke filluar nga krahu i djathtë.

Kërkesat e Namazit

Ekzistojnë dymbëdhjetë kërkesa që duhen plotësuar, në mënyrë që një namaz të konsiderohet i vlefshëm; gjashtë kërkesat e para quhen Kushtet e Namazit dhe duhen plotësuar përpara faljes së tij, ndërsa gjashtë të tjerat quhen Shtyllat e Namazit, të cilat duhen plotësuar gjatë faljes së tij.

Kushtet e Namazit

Marrja e abdestit

Sigurimi që trupi, rrobat dhe zona në të cilën do të falni namaz, janë të pastra.

Veshja siç duhet në mënyrë që pjesët e trupit që duhen mbuluar të jenë të mbuluara (burrat duhet të mbulojnë trupin të paktën që nga kërthiza e deri tek gjunjët, ndërsa gratë duhet të mbulojnë gjithë trupin, me përjashtim të fytyrës, duarve dhe këmbëve).

Falja e namazit në kohën e duhur (në rast se për ndonjë arsye një person nuk mund ta falë namazin në kohën e caktuar, ai mund të falet më vonë).

Falja e namazit në drejtim të Kibles (Qabes).

Bërja e nijetit për namazin përkatës.

Shtyllat e Namazit

1. Fillimi duke marrë tekbirin fillestar me fjalët “Allahu ekber” (Allahu është më i Madhi).
2. Qëndrimi në këmbë (kijam).
3. Recitimi i pjesëve nga Kur’ani.
4. Përkulja dhe vendosja e duarve në gjunjë (ruku).
5. Rënia përdhe (vendosja e fytyrës në tokë duke u gjunjëzuar, sexhde).
6. Qëndrimi i ulur në gjunjë (teshehud).

Falja e namazit – një shembull në dy rekate:

Duke përjashtuar disa ndryshime të vogla, si burrat, ashtu edhe gratë, e falin namazin në të njëjtën mënyrë. Megjithëse nuk janë të detyrueshme, është e pëlqyeshme të kihen parasysh këto ndryshime që janë theksuar më poshtë.

Qëndrojmë në këmbë në një vend të pastër me fytyrë nga Kibla dhe bëjmë nijetin e faljes, duke specifikuar emrin e namazit që duam të falim: “Unë po fal namazin e sunetit në emër të Allahut.” Në qoftë se jemi duke u falur me xhemat, shtojmë edhe “...pas këtij imami.”

Themi tekbinin fillestar: “Allahu ekber”.

Burrat: kur thuhet “Allahu ekber,” ngrihen duart deri tek veshët me pëllëmbët e hapura të drejtuara Kiblës. Pastaj vendosen duart të mbledhura nën kërthizë, e djathta mbi të majtën, duke rrethuar kyçin e dorës së majtë me gishtat e dorës së djathtë. Sytë mbahen të fiksuar në vendin ku do të vihet koka gjatë sexhdes.

Gratë: kur thuhet “Allahu ekber” ngrihen duart në lartësinë e supeve. Bashkohen gishtat, pëllëmbët janë të hapura dhe të drejtuara nga Kibla. Pastaj vendosen duart në kraharor, e djathta mbi të majtën, por nuk rrethohet kyçi i dorës së majtë si tek burrat. Gishtat mbahen të bashkuar. Sytë mbahen të fiksuar në vendin ku do të vihet koka gjatë sexhdes.

1. Gjatë qëndrimit në këmbë lexohet Subhaneke dhe Fatihaja (Sureja që hap Kur’anin), e pasuar nga një pjesë tjetër nga Kur’ani (një Sure, ose minimumi tre ajete të një Sureje). Ky lloj recitimi i bërë kur personi qëndron në këmbë, quhet kiraet. Ju lutem kini parasysht që në rekatin e parë përpara Fatihas, thuhet “Eudhu bil’lahi mineshejtani rraxhim, Bismil’lahi Rrahmani Rrahim.”

2. Pas kiraet-it vjen ruku-ja (përkulja). Thuhet “Allahu ekber,” lëshohen duart anash dhe bëhet përkulja.

Burrat: Bëhet një përkulje e plotë. Duhet të sigurohemi që koka dhe shpina të jenë në vijë të drejtë. Duart vendosen mbi gjunjë duke i mbajtur gishtat e hapur.

Gratë: Bëhet një përkulje e lehtë e kokës në mënyrë që shpina të jetë paksa e përkulur, koka duhet mbajtur më lart sesa pjesa e poshtme e kurrizit. Gjunjët duhet të jenë paksa të përthyer. Pastaj vendosen duart mbi gjunjë duke mbajtur gishtat të hapur.

3. Thuhet tre herë “Subhane Rabbije’l Adhim” (Lavdia i takon Zotit Tim, më të Madhit).

4. Pastaj ngrihemi nga rukujat duke thënë “Semi Allahu limen hamideh” (Allahu e dëgjon atë që e falenderon) gjatë ngritjes; duart vihen anash trupit dhe thuhet “Rabbena ve lekel hamd” (Zoti ynë, falenderimi të qoftë Ty).

5. Thuhet “Allahu ekber” dhe pastaj bihet në sexhde. Vendoset koka midis duarve dhe sigurohemi që si balli, ashtu edhe hunda, të kenë prekur tokën. Gishtat e këmbëve duhet të jenë të përthyer në mënyrë që pjesa e poshtme e tyre të jetë e takuar me tokën.

Burrat: Vendosen bërrylat në mënyrë të tillë që të mos jenë në kontakt me tokën ose me pjesët e trupit tuaj. Duhet të sigurohemi që thembrat t'i kemi të bashkuara.

Gratë: Vendosen bërrylat në mënyrë të tillë që të jenë në kontakt me tokën. Barku duhet të takojë gjunjët.

6. Thuhet “Subhane Rabbije'l A'la” (Lavdia është për Zotin Tim, më të Lartin) tri herë kur vendosim ballin në tokë.

7. Thuhet “Allahu ekber,” ngrihemi nga sexhdja në pozicionin e uljes në gjunjë, presim për një moment dhe themi përsëri “Allahu ekber” dhe bëjmë një sexhde tjetër.

8. Them “Allahu ekber” dhe ngrihemi për rekatin e dytë.

9. Recitohet “Bismil'lahi Rrahmani Rrahim” dhe Fatihaja, të pasuara nga një pjesë nga Kur'ani dhe përsëriten rukuja dhe sexhdja.

10. Pas sexhdes së dytë qëndrohet në gjunjë. Në varësi të numrit të rekateve në një namaz të caktuar, ulja bëhet pas rekatit të dytë, të tretë apo të katërt.

11. Vendosen gishtat e pëllëmbëve mbi gjunjë. Pastaj thuhet lutjet: “Ettehiyati,” “Allahumme Sal'li-Barik” dhe “Rabbena”, ndërsa jemi të ulur mbi gjunjë.

Burrat: Këmba e djathtë vendoset vertikalisht, me gishtat e saj të drejtuara nga Kibla.

Gratë: Të dy këmbët kthehen nga e djathta. Kofsha e majtë duhet të prekë tokën.

12. Namazi përfundon duke dhënë një urim paqeje. Kthehet fytyra nga ana e djathtë dhe thuhet “esselamu alejkum ue rahmetullah” (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju). Pastaj kthehet fytyra nga ana e majtë dhe thuhet e njëjta gjë.

Agjërimi i Ramazanit

Fjala saum në arabisht, është e njëvlershmja e fjalës “agjërim” dhe ka kuptimin e “qëndrimit pa u ushqyer.” Agjërimi në praktikën Islame nënkupton largimin vullnetar nga dëshirat e epshit, duke

hequr dorë vullnetarisht nga ushqimet, pijet dhe marrëdhëniet seksuale, që nga momenti i hyrjes së vaktit të sabahut e deri në përfundim të diellit, me qëllim forcimin e disiplinës dhe vetëkontrollit shpirtëror.

Agjërimi në praktikën islame hyri në muajin Shaban (muajin e tetë të kalendarit islam), të vitit të dytë pas emigrimit të Profetit në Medinë.

Agjërimi i muajit të Ramazanit (muaji i nëntë sipas kalendarit islam), përbën një nga pesë shtyllat e Islamit; ai urdhërohet në Kur'an, prandaj është një praktikë e detyrueshme. Në Kur'an çështjet janë trajtuar në mënyrë të përgjithshme. Ishte Profeti Muhamed ai që dha shpjegime të detajuara në lidhje me urdhëresat fetare të dhëna në Kur'an, sepse ai ishte interpretuesi i parë dhe më i madh i Librit të Shenjtë. Rëndësia e agjëritimit në Kur'an theksohet qartë në ajetin në vijim:

O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të mund të ruheni nga të këqijat. (Bekare 2:183)

Ky ajet gjithashtu aludon për faktin se agjërimi qe një praktikë e urdhëruar për besimtarët përpara ardhjes së Islamit. Origjina e tij mund të gjendet në gjurmët e feve të mëparshme. Pavarësisht disa ndryshimeve në lidhje me praktikimin e agjëritimit në sisteme të ndryshme besimi, agjërimi si një institucion i arsyeshëm shpirtëror, përbën një praktikë të përbashkët të të gjitha feve dhe është i përcaktuar si në Judaizëm, edhe në Krishtërim. Inxhili (Ungjilli) thekson se si Isai (a.s.), ashtu edhe Musai, Danieli, Iljasi dhe Davudi (a.s.), që të gjithë kanë agjëruar. Musait (a.s.) iu dha Libri pasi agjëroi për dyzet ditë. Po kështu, Isai (a.s.) agjëroi për dyzet ditë me radhë në shkretëtirë përpara se të thirrej për të kryer misionin e tij. Profeti Davud (a.s.), agjëronte çdo dy ditë. Ky agjërim i Davudit konsiderohet si një nga më të vlefshmit të këshilluar nga praktikantët islame. Megjithatë tashmë jo i praktikuar nga shumica e kristianëve, agjërimi mbahet në një formë ose në një tjetër nga katolikët romanë, të krishterët ortodoksë dhe në shumicën e sekteve protestante, në të cilat konsiderohet si një përvojë shpirtërore personale.

Qëllimi i vetëm i agjëritimit në Islam, është kërkimi i kënaqësisë së Zotit me anë të bindjes ndaj Urdhrave të Tij. Nuk është qëllimi vetëm tek kufizimi i ushqimit të tepërt apo pastrimi i trupit nga lëndët toksike. Agjërimi i ndihmon muslimanët të pajisen me mëshirë, si një mënyrë për të qenë gjithmonë të vetëdijshëm për urdhrat e Allahut, për të bërë vepra të mira dhe për ta ruajtur vetveten nga e keqja.

Njerëzit që janë përkohësisht të sëmurë apo në udhëtim, mund ta prishin përkohësisht agjërimin e tyre, por duhet t'i zëvendësojnë ditët e lëna mangët. Gratë gjatë periudhës së menstruacioneve

dhe ato lehona nuk agjërojnë, ndaj duhet t'i zëvendësojnë më pas ato ditë që u mungojnë, për të plotësuar numrin. Njerëzit me sëmundje kronike duhet të ushqejnë një person të varfër për çdo ditë që lënë pa agjëruar dhe nuk janë të detyruar t'i zëvendësojnë ato. Dijetarët bien dakord në mendimin që gratë lehona dhe shtatzëna, të cilat kanë frikë për shëndetin e tyre apo për shëndetin e fëmijëve të tyre, mund të mos agjërojnë derisa kushtet t'ua lejojnë një gjë të tillë. Dijetarët ndahen vetëm në opinionet e tyre në lidhje me atë se a duhet t'i zëvendësojnë këto gra ndonjëherë ato ditë apo duhet të ushqejnë një të varfër.

Agjërimi i zvogëlon dëshirat e një personi. Ai e stërvit atë për të qenë më i vetëpërmbajtur dhe e mëson të jetë më i kujdesshëm me vetveten. Në qoftë se dikush është në gjendje të heqë dorë nga ato që i lejohen për një kohë të kufizuar, atëherë ai është gjithashtu në gjendje të heqë dorë edhe nga ato gjëra që nuk i lejohen. Agjërimi e zhvendos vëmendjen nga nevojat trupore tek ato shpirtërore. Kjo zhvendosje vëmendjeje është pjesë përbërëse e Ramazanit, duke i bërë njerëzit të shpenzojnë më tepër kohë në leximin e Kur'anit dhe në faljen e namazeve nafile (suplementare). Në mënyrë që agjërimi të shpërblehet, heqja dorë nga ushqimet dhe pijet, duhet të shoqërohet nga heqja dorë edhe prej veprimeve të paligjshme. Profeti ka thënë: “Allahu nuk ka nevojë për qëndrimin pa ngrënë e pa pirë të atij që nuk heq dorë nga fjalët dhe veprat e këqija.”³⁸

Ndjesia e urisë që lind natyrshëm gjatë agjërit, e bën gjithashtu një person t'ua kuptojë vështirësitë atyre që janë të uritur jo për zgjedhjen e tyre, por sepse nuk mund të gjejnë ushqim të mjaftueshëm, prandaj Ramazani shndërrohet në një muaj të bamirësisë, krahas të qenit muaji i agjërit.

Agjërimi është i detyrueshëm për muslimanët e rritur dhe të shëndetshëm vetëm në Ramazan. Megjithatë, ekzistojnë edhe ditë të tjera kur ai këshillohet të mbahet, siç janë: tri ditët e mesme të çdo muaji, si dhe çdo të hënë dhe të enjte. Agjërimi i rregullt ndihmon në mbajtjen e gjendjes mendore në atë nivel sikurse në muajin e Ramazanit.

Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër, le të agjërojë më vonë aq ditë sa nuk ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë. (Bekare 2:185)

Zekati (Lëmosha Pastruese)

Bamirësia shprehet në Islam në forma të ndryshme. Ndërsa sadakaja (bamirësia) është një akt vullnetar, zekati është një detyrim për çdo musliman që zotëron një nivel të caktuar pasurie. Fjala zekat rrjedh nga fjala tezekka që do të thotë “të pastrosh diçka.” Prandaj, zekati nënkupton mbajtjen e pasurisë të pastër dhe të shenjtë, duke u dhënë 2.5 përqind të saj të varfërve. Rrjedhimisht, ky akt e bën besimtarin dhe pasurinë e tij të qëndrojë përherë në nivele pastërtie dhe sinqeriteti (Tevbe 9:103). Zekati është një shtyllë shumë e rëndësishme e praktikës islame dhe kjo vërtetohet nga barazimi që i bëhet asaj me namazin, gjithsej 82 herë në Kur’an.

Bamirësia është një virtut i nxitur nga të gjitha fetë hyjnore të shpallura më parë dhe nga të gjitha sistemet e tjera të besimit. Islami nuk e ndalon fitimin e pasurisë, që është në natyrën e njerëzve, por i nxit të pasurit ta ndajnë pasurinë e tyre me të varfërit. Allahu është i vetmi pronar i vërtetë i gjithçkaje, ndaj Ai u ka dhënë një farë të drejte edhe të varfërve në pasurinë e të pasurve, prandaj pretendimi i dikujt se çdo gjë që zotëron i përket atij dhe nuk pranon ta ndajë pasurinë me të varfërit, përbën në fakt sekuestrim të të drejtës së të varfërve dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Djali ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij. Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm. (Bekare 2:268)

Allahu nga ana tjetër, ka premtuar se pasuria nuk do të pakësohet kurrë për shkak të dhënies së lëmoshës.

Thuaj: “S’ka dyshim se Zoti im është Ai që i jep begati të bollshme kujt të dojë nga robërit e Tij dhe ia pakëson kujt të dojë. Ai ua kompenson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i madh. (Sebe’ 34:39)

Zekati përbën një formë të detyrueshme bamirësie të marrë nga kursimet e një personi. Ai nuk është një taksë mbi të ardhurat, por një taksë mbi kursimet. Përfituesit më të mëdhenj të tij janë punëtorët e varfër që nuk mund t’i plotësojnë të gjitha nevojat e tyre pa njëfarë ndihme shtesë, si dhe të mjerët që nuk janë në gjendje të sigurojnë as edhe mjetet bazë të jetesës. Ai përdoret gjithashtu për të paguar borxhet e atyre që nuk kanë mundësi t’i paguajnë vetë, për lirim të skllëvërve dhe të robërve të luftës.

Zekati është gjithashtu një virtut i rëndësishëm i muslimanëve dhe Allahu i paralajmëron ata që nuk e japin se do të kenë “një ndëshkim të dhimbshëm,” siç përshkruhet edhe në ajetin e mëposhtëm kur’anor.

Besimtarët dhe besimtares janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë nga të këqijat; e falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se Allahu është me të vërtetë i Plotfuqishëm, i Urtë. (Tevbe 9:71)

Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhimbshëm. (Tevbe 9:34)

Haxhi

Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi ta përballojë udhën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd. (Al Imran 3:97)

Shtylla e pestë dhe e fundit e Islamit, Haxhi, konsiston në kryerjen e një udhëtimi në Mekë për t'iu bashkangjitur xhematit më të madh njerëzor në tokë. Haxhi është një udhëtim i shenjtë nga materialja tek shpirtërorja dhe përbën një përkujtim të faktit që ne jemi vetëm udhëtarë në këtë botë. Haxhi është një nënshttrim i plotë i besimtarit ndaj Allahut dhe përbën një namaz universal, në të cilin besimtarët i heqin rrobat e tyre të zakonshme dhe veshin rroba të thjeshta derisa të gjithë të pranishmit të arrijnë ta shikojnë njëri-tjetrin me mëshirë dhe përlësi. Ai përshkruhet më së miri me fjalët që pelegrinët shqiptojnë në çastin kur janë duke u rrotulluar rreth Qabes në tavaf:

Këtu jam o Allah, këtu jam, në shërbimin Tënd.

Ti je i pashoq. Ty të takojnë të gjitha falenderimet dhe lavdërimet, dhe i Yti është i gjithë sundimi.

Ti je i pashoq.

...”Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, të mira edhe në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit!” (Bekare 2:201)

Kur u ndërtua Qabja për herë të dytë pas Ademit (a.s.) nga Profeti Ibrahim (a.s.) dhe i biri Ismaili (paqja qoftë mbi ta), Allahu e urdhëroi Ibrahimin t'i bënte thirrje njerëzimit për ta madhëruar Atë, duke vizituar Shtëpinë e Tij (Bejtullah). Kjo thirrje përbën një detyrim për të gjithë muslimanët që janë në gjendje ta përballojnë atë, të paktën një herë në jetën e tyre.

Përkujtoje kur Ne e udhëzuam Ibrahimin për në vendin e Faltores (Qabes). Mos më shoqëro asgjë në adhurim dhe pastroje shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull sa (në shenjë adhurimi), që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulen e bien në sexhde. Dhe thirri njerëzit për haxhillëk, ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta. (Haxh 22:26-27).

Haxhi përbën një pikë kthese në ecurinë shpirtërore të besimtarëve. Kur viziton Qaben, shtëpinë e parë të adhurimit të ndërtuar me urdhrin e Allahut, një pelegrin takon Ademin, babanë e njerëzimit; ndjen gëzimin që një udhëtar ndjen kur kthehet në shtëpi; bëhet dëshmitar për faktin se cilësitë tokësore si raca, prejardhja, statusi, bukuria dhe rinia nuk janë asgjë tjetër përveçse tituj të përkohshëm, të destinuar të humbasin. Ai do të përjetojë në ato momente një episod nga shfaqja e madhe e Ditës së Ringjalljes, ditë kur atij do t'i duhet të japë llogari përpara Zotit tonë për gjithçka ka bërë në jetë. Kjo është arsyeja përse Qabja është “pika e referimit” për njerëzit, shumica e të cilëve bëjnë një jetë edhe më të virtytshme pas haxhit.

Allahu e bëri Qaben, Shtëpinë e Shenjtë, vend jetësimi për njerëz. (Maide 5:97)

Bediuzzaman Said Nursi e përshkruan haxhin në këtë mënyrë:

Haxhi shpreh një akt adhurimi të shkallës më të lartë të mundshme. Ai është çelësi që u hap pelegrinëve shumë dyer të prezantimit të mbretërisë universale hyjnore. Ai paraqet horizontet e Madhështisë Hyjnore që ne nuk arrijmë t'i shohim ndryshe. Nderimi i thellë dhe mahnitja, ndjenja që përjetojmë përballë madhështisë së Mbretërisë Hyjnore (e shkaktuar prej ndjenjës së adhurimit dhe gatishmërisë për të shërbyer), si dhe shkallët e prezantimeve të pashfletuara në zemrat dhe imagjinatën e tyre (të përjetuara duke kryer ritualet e haxhit), mund të përjetoohen vetëm duke përsëritur vazhdimisht: “Allahu është më i Madhi.” Vetëm kjo frazë mund t'ia shprehë një shkallë të tillë manifestimi njerëzimit. (Fjala e Gjashtëmbëdhjetë, Rrezja e katërt)

Një përshkrim i shkurtër i ritualeve

E thënë shkurt, haxhi është një bashkësi ritualesh të kryera në Mekë dhe në disa rrethina të shenjta rreth saj, në dy javët e para të muajit të Dhulhixhes (muaji i dymbëdhjetë i kalendarit hixhri). Pelegrinët hyjnë në vendin e shenjtë në gjendje ihrami, d.m.th. me qëllimin për ta kryer vizitën duke zbatuar disa rregulla të caktuara. Në fakt, ritualet e kryera gjatë haxhit datojnë që

përpara shekullit të shtatë, kur fesë iu dha trajta e saj përfundimtare. Gjatë haxhit, pelegrinët përkujtojnë ribashkimin e Profetit Adem dhe Havasë, si dhe faljen e tyre nga Allahu në Fushën e Arafatit dhe në Malin e Mëshirës, ndërsa përshkojnë të njëjtën rrugë ndërmjet kodrave Safa dhe Merve, të cilën pati përshkuar Haxherja, gruaja e Profetit Ibrahim, kur po kërkonte ujë për djalë e saj Ismail.

Më hollësisht, haxhi përmban ritualet e mëposhtme:

Ihrami: Qenia në gjendjen e ihramit nënkupton moskryerjen e punëve të ndaluara gjatë kohës së haxhit (marrëdhëniet seksuale, grindjet, veshja e rrobave të qepura, vrasja e kafshëve, prerja e bimëve dhe e pemëve). Burrat veshin një uniformë karakteristike për këtë ritual të përbërë prej dy copave të bardha të paqepura fabrikisht.

Vakfe: Përfshin qëndrimin në Arafat deri në mbrëmjen e ditës së nëntë të Dhulhixhes, natën e Kurban Bajramit, qëndrimin në Muzdelife në kohën ndërmjet agimit dhe lindjes së diellit në ditën e Bajramit për të paktën një orë. Muzdelife ndodhet rreth njëzet kilometra larg Mekës dhe dhjetë kilometra larg Arafatit.

Tavafi: Përbën kryerjen e shtatë rrotullimeve rreth Qabes

Sa'j: Nënkupton një ecje të shpejtë ndërmjet kodrave të Safas dhe Mervesë pranë Qabes.

Xhemerati: Është goditja me nga shtatë gurë të vegjël e secilës nga shtatë kolonat prej guri (xhemerat) në Mina, aty ku Profeti Ibrahim kundërshtoi djallin.

Therja e një kurban brenda tri ditëve, duke filluar që nga momenti i goditjes së shtyllave me gurë në ditën e parë të Bajramit, dhe qethja ose rruarja e flokëve brenda rrethinave të shenjta të Mekës. Grave u duhet vetëm t'i shkurtojnë paksa flokët.

Gjëra të ndaluara dhe gjëra të lejuara

Jeta në Islam e pajisur me adhurim (ibadet), si dhe marrëdhëniet shoqërore, drejtojnë të gjitha aspektet e jetës së individit. Ligji Islam i sistemon të gjitha veprimet njerëzore sipas kategorive që janë: veprime të detyrueshme (farzet), veprime të ndaluara (haram), veprime jo të pëlqyeshme (mekruh) dhe veprime të lejuara (mubah). Këtu ne do t'u hedhim një vështrim të shkurtër veprimeve të ndaluara.

Në kundërshtim me perceptimin e përgjithshëm, Islami u lejon një hapësirë të gjerë veprimi besimtarëve, në mënyrë që ata të jetojnë në mirëqenie pa bërë asnjë shkelje. Bediuzzaman Said Nursi e sqaron këtë pikë në mënyrë mjaft të saktë: “Kufijte e të lejuarës janë të gjerë dhe të përshtatshëm për dëshirat tona, ndaj nuk është nevoja të zhytemi tek gjërat e ndaluara.” Islami e pranon se çdo gjë që Zoti ka krijuar, është në thelb për të mirën e njerëzimit dhe e ligjshme (hallall), përderisa nuk është ndaluar nga Kur’ani ose Profeti. Gjërat e ndaluara në Islam mund të renditen shkurtimisht si vijon:

- Ngrënia e mishit të disa kafshëve të caktuara, siç janë mishi i derrit, mishi i ngordhur, mishi i kafshëve mishngrënëse, mishi i zogjve me kthetra, i amfibëve, i zvarranikëve, si dhe mishi i kafshëve të therura në emër të dikujt tjetër përveç Zotit.
- Konsumimi i lëndëve dehëse si alkooli, droga etj., dhe i gjërave të tjera të dëmshme. Një musliman duhet të jetë gjithmonë plotësisht i kthjellët dhe i ndërgjegjshëm për Zotin e tij dhe të jetë në gjendje t'i drejtohet Zotit të Madhëruar gjatë gjithë kohës, në veçanti gjatë kohës së namazeve. Dëmet që alkooli apo pijet e tjera dehëse i shkaktojnë individit dhe shoqërisë, janë të panumërta dhe të pallogaritshme.
- Zgjedhja me kujdes e veshjes. Islami nxit modestinë, prandaj veshjet ekstravagante dhe dëshira për t'u dukur janë të ndaluara. Si burrat, ashtu edhe gratë, duhet të jenë gjithashtu të kujdesshëm të mos vishen në mënyrë të tillë që të tundojnë seksin e kundërt, si për shembull, me anë të veshjeve transparente ose të shkurtra. Pra, trupi duhet të jetë i mbuluar siç duhet, në përputhje me etikën Islame.
- Shmangia nga të gjitha format e bixhozit dhe kamatës, siç janë interesi i huave dhe lojërat e fatit.

Islami dhe kultura

Islami sot është i përhapur në të gjithë botën, në qindra vende të ndryshme, në etni dhe grupe racore të ndryshme. Muslimanët janë të bashkuar nën flamurin e Islamit dhe e mirëpresin njëri-tjetrin si pjesëtarë të së njëjtës familje. Pavarësisht aderimit në disa kultura me vlera të veçanta, ata ende përjetojnë një diversitet të pasur dhe mbeten thelbësisht të lidhur nëpërmjet të njëjtit sistem besimi dhe të njëjtave pikëpamje. Muslimanët mund të përshtaten me normat sociale të shoqërive të tyre, të cilat janë zhvilluar përgjatë shekujve si rrjedhojë e faktorëve rajonalë, siç janë klima, industria, trashëgimia, shijet kombëtare, etj. Ndryshimet e shfaqura janë të gjitha të pranueshme, me kusht që të mos jenë të ndaluara shprehimisht nga Islami.

Bibliografi

- 1 Ismail Byjyqçelebi, Jeta nën Hijen e Islamit, The Light, Inc NJ: 2005, f.5.
- 2 Roger Du Pasquier, Duke Zbuluar Islamin, Shoqëria e teksteve Islamike, Cambridge: 1994, f.7.
- 3 Akbar S. Ahmed, Islami Sot, I.B. Tauris, Londër: 2001, f.24.
- 4 Byjyqçelebi, 2005, f.4.
- 5 Seyyed Hossein, Zemra e Islamit, Harper San Francisco, NY: 2002, f. 9-11.
- 6 Hadith kudsi quhet një thënie e Profetit e cila nuk është pjesë e Kur'anit dhe me anë të së cilës Allahu flet në vetën e parë nëpërmjet gojës së Profetit.
- 7 Bediuzzaman Said Nursi, Fjalët, Fjala 11-të, The Light, Inc. NJ:2005, f.133-141
- 8 Bukuri dhe përsosmëri e veçantë e cila admirohet nga të gjithë prej së cilës të tjerët kanë dobi.
- 9 Ashtu si Bibla edhe Kur'ani thotë se Allahu e krijoi gjithësinë në gjashtë ditë. Megjithatë Kur'ani asnjëherë nuk ka parasysh mëngjeset dhe mbrëmjet si dhe "ditët" aktuale si një periudhë relative krahasimi, prandaj gjatësia e ditëve të krijimit të universit është e panjohur. Shih 22:47, 32:5 si dhe 70:4.
- 10 Fjala në origjinal e përkthyer si "Zot" është Rabb. Ajo e përkufizon Zotin si Ai i Cili i sjell në jetë, i stërvit, i edukon, i mbështet dhe i administron krijesat e Tij. Shënim: Nuk duhet ngatërruar me konceptin kristian të Zotit të quajtur Jezu Krisht dhe të njohur si i "biri i Allahut."

11 Koncepti “mëkëmbës të Zotit” nënkupton qeniet njerëzore të përdorura nga Allahu si “mjet” për ekzekutimin e urdhrave të Tij në tokë dhe qeverisjen në të, në përputhje me ligjet e Tij.

12 Islami e konsideron një person se ka arritur moshën e pjekurisë kur ai ose ajo piqen fizikisht.

13 Ibn Hanbel, 5:441.

14 Muslim, Imaeah, 37.

15 Ibn Haxher, 1:165.

16 Buhari. Iman,22.

17 Muslim, Fada'il as-Sahabah, 63.

18 Joseph Hell, Qytetërimi Arab, f. 10.

19 Ibn Hisham, Sirat al Nabaviya, 1:282.

20 Nga libri “Duke kuptuar Islamin” nga Al-Mevdudi (botim dhe përmbledhje) I.I. F.S.O., 1970, 69-60.

21 Tirmidhi, Hn: 3069.

22 Darimi, Sunen, 2:533.

23Ibn Kethir, 3:80-81; Ibn Hisham, 1:313.

24 ibid. 61.

25 Yildirim, ibid., 66-70; al-Salih, ibid., 65-73.

26 Marrë nga A. Kerim në “Kontributi i Islamit në shkencë dhe qytetërim”

27 Botimi tre-mujor i Pakistanit, vol 4, nr 3.

28 Për këtë shih Abul A'la al-Mevdudi, “Duke Kuptuar Islamin” (Kuvait: IIFSO, 1970), 69-70, shën 1.

29 Abul-Fazl Ezzati, “Një Hyrje në Historinë dhe Përhapjen e Islamit” (Londër 1978), 378.

30 Sir Thomas Arnold dhe Alfred Guillaume, “Trashëgimia e Islamit” (Oxford, Uk: Clarendon, 1931 {1947}), 9.

31 Indiculus Luminosus, përkth. nga Dozy dhe cituar nga Ezzati, “Parathënie,” 98-99.

32 Cituar nga Ezzati, “Parathënie,” 235-37

33 Seyyed Hossein nasr, “Zemra e Islamit,” HarperSanFrancisco, NY: 2002,f.3.

34 Buhari, Iman, 1; Muslim, Iman, 20.

35 Buhari, Enbija, 47; Muslim, Iman, 46; Tirmidhi, Iman, 17.

36 Muslim, Iman, 50.

37 Muslim, Iman, 45.

38 Buhari, Saum, 8.